



Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan

Rr. “Zija Shemsiu”, PN. Gjilan, 60000 Kosovë Tel.: +383280390112, www.uni-gjilan.net

Ref. Nr.02/598 Dt. 29 / 03 /2023

Në mbështetje të Nenit 24, pika 1, të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan, Këshilli Drejtues publikon Raportin Vjetor të Punës për vitin 2022

Raporti Vjetor i Punës- 2022

Gjilan, 12.03.2023

Në mbështetje të Nenit 24, pika 1, të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, Këshilli Drejtues publikon Raportin Vjetor të Punës për vitin 2022. Rektori i Universitetit, prof. dr. Bajram Kosumi, më datën 01.02.2023 me vendimin Nr.01/197, formoi grupin e punës për përgatitjen e Raportit Vjetor të Punës së UKZ-së për vitin 2022, në përbërje të:

1. Prof. Dr. Xhevdet Thaqi,
2. Prof. Ass. Dr. Bajram Fejzullahu,
3. Dr.Sc. Vaxhid Sadriu, dhe
4. Luljetë Berisha.

Përmbajtja

1. Fjala e Rektorit	4
1.1. Objektivat e përgjithshme strategjike të arritura.....	5
1.2. Të dhënat e përgjithshme statistikore të UKZ-së.....	11
1.2.1. Buxheti (fondet publike dhe private)	11
1.2.2. Personeli (shifrat zhvillimore).....	18
1.2.3. Infrastruktura.....	23
1.2.4 Profili akademik (ndryshimet në personelin akademik, fushat e studimit	34
1.2.5. Programet e studimit	35
1.2.6. Numri i studentëve (studentët e regjistruar për herë të parë, numri i përgjithshëm i studentëve, të diplomuarit).....	37
1.2.7 Kërkimet shkencore (projektet, publikimet, pjesëmarrja në konferenca, punimet)	42
1.2.8 Bashkëpunimi ndërkombëtar	59
Përfundim.....	76

1. Fjala e Rektorit

Universiteti Publik “Kadri Zeka” edhe gjatë vitit 2022 vazhdoi traditën e punës përkrijimine filozofisë së lirisë, shoqërisë së lirë e moderne, krijimin e vlerave të demokracisë, krijimin e mendimit kritik e të njeriut të lirë, si dhe një kulturë pozitive nationale e shtetërore.

Tashmë duke hyrë në një epokë të re, në epokën virtuale, janë bërë veprimet e duhura që UKZ-ja të përshtatet dhe të gjejë rolin e vet. Statusi i dijes në epokën e internetit dhe të botës virtuale ka ndërruar e po ndërron me shpejtësi të madhe. Kjo e afirmoi dijen, por njëkohësisht, krijon mundësi për shpërdorimin e saj. Veprimitaria e UKZ-së është orientuar gjithnjë që të jetë rruga më e sigurt për ruajtjen e statusit të dijes në shërbim të njerëzimit.

Në anën tjeter, UKZ-ja ka vazhduar ta ndërlidhë sa më mirë mësimin e hulumtimin akademik me tregun e punës në dy drejtime:

- 1) Hulumtimi shkencor të jetë në favor të ekonomisë dhe të komunitetit, prandaj gjatë vitit 2022 janë krijuar marrëveshje bashkëpunimi me partnerët tanë të komunitetit;
- 2) Një pjesë e studentëve, të cilët hyjnë në treg të punës pas përfundimit të studimeve, të jenë të përgatitur profesionalisht për këtë treg. Prandaj UKZ-ja ka vazhduar me rritjen e interesimit për praktikat e studentëve, për studimin e tregut të punës dhe përputhshmërinë e programeve studimore me këtë treg.

UKZ-ja ka ngritur performancën, sidomos në dy fusha ndërkombëtare gjatë vitit 2022:

- 1). Ka një rritje të dukshme të publikimeve shkencore të stafit të UKZ-së nëpër revistat ndërkombëtare me impakt faktor, të indeksuara në rrjetet e njohura Web of Science dhe në Scopus;
- 2). Ka një zgjerim të dukshëm të pjesëmarrësve nga radhët e stafit akademik dhe administrativ në projektet ndërkombëtare, veçanërisht në projekte të Erasmus+. Po ashtu, ka një rritje të interesimit të stafit akademik edhe për shkrimin e projekteve ndërkombëtare. E të gjitha këto janë dëshmi se UKZ-ja është e përkushtuar për të hyrënë konkurrencë në tregun europian të arsimit të lartë.

Mund të përfundojmë, se rezultati i përgjithshëm i UKZ-së në vitin 2022 është pozitiv. Tanimëe shohim me besim të plotë, se shoqëria dhe shteti ynë gjijnë te UKZ-ja partnerin serioz për arsimin e të rinjve; për përgatitjen e tyre për punë, për përgatitjen e tyre përrugën e gjatë të shkencës, por edhe për të krijuar qytetarë me mendje të lirë e të hapur, të përgjegjshëm për veten dhe shoqerinë.

Na priftë e mbara!

Prof. dr. Bajram Kosumi

1.1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE të arritura

Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan gjatë vitit 2022 ka vazhduar veprimitarinë e tij, duke krijuar kushte për studentët dhe stafin e UKZ-së; për krijimin dhe avansimin e vlerave themelore njerëzore, për secilën kohë dhe në çdo hapësirë, e përcaktuar nga vizioni i UKZ-së. Veprimitaria e UKZ-së edhe gjatë vitit 2022, vazhdon të kultivojë nxënien dhe zhvillimin e dijeve, nxitjen e mendimit kritik dhe shpirttë ndërmarrësisë për hulumtime të reja, të cilat e ndihmojnë zhvillimin shoqëror dhe atë teknologjik. Gjithashtu, përgatit të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie virtuale dhënguese; për të qenë pjesë e një tregu të hapur të punës dhe njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë, të përcaktuar nga misioni i UKZ-së (*Plani strategjik i UKZ 2017-2022, i rishikuar*).

Viti 2022 është vit kur duhet të hartohen dokumente të politikave afatmesme; Këshilli Drejtues i UKZ-së filloj hartimin e Planit Strategjik të UKZ-së për periudhën 2023-2027 (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/ukz-eshte-ne-procesin-e-hartimit-te-planit-strategjik-2023-2027/>).

Qëllimi i PlanitStrategjik është të kapë themelet e një vizioni dhe të kuptimit të përbashkët, të rolit e të identitetit të UKZ-sënë kontekstini e kërkesave të shumta dhe në ndryshim në nivel kombëtar, si dhe në një botë globale gjithnjë e më të ndërlidhur. Ciklet pesëvjeçare 2023-2027 të planifikimit dhe të zbatimit do të vendosenbrenda këtij kuadri ose strategjie, në mënyrë që të shfrytëzohet plotësisht natyra dinamike e ndryshimit qëduhet të mbajë gjallérinë e UKZ-së brenda trajktoret së tij të parashikuar.

Me vendim të KD është formuar Grupi Punues për hartimin e Planit Strategjik, i cili ka filluar punën; janë mbajtur dy takime, me ç'rastështë përcaktuar metodologja e punës dhe janë ndarë detyrat. Përcaktimi i gjendjes aktuale në UKZ është bërë përmes analizës SWOT, për të vazhduar tutje në bashkëpunim me HERAS, të hartojë një raport për “Përputhshmërinë e Programeve Studimore me Tregun e Punës”.

Gjatë vitit 2022 UKZ-ja ka arritur suksese në këto objektiva të përgjithshme strategjike:

1. Objktivi strategjik: Universiteti, shoqëria dhe tregu i punës të jetë një cikël dhe proces i ndërlidhur

- Hulumtimet e zhvilluara të stafit akademik të UKZ-së janë të ndërlidhura me zhvillimin e shoqërisë, duke afirmuar shkencën dhe rezultatet, në mënyrë që t'u përgjigjen sfidave ekonomike, juridike, politike dhe edukative të shoqërisë. Është punuar që studentët tanë të pajisen me njohuri të transferueshme dhe pas diplomimit të jenë konkurrentë në tregun vendor, rajonal dhe evropian të punës, duke përfshirë sektorin privat dhe publik.
- UKZ ka organizuar **Konferenca** (Konferenca Vjetore AC UKZ 2022, “*Roli i teknologjisë në formësimin e shoqërisë*”, debate dhe ligjérata nga personalitetë të ftuara), ka organizuar ekipe të ekspertëve nga fusha e ekonomisë (FEK), nga fusha e digitalizimit (FSHK, strategjia “*Smart City*”: <https://www.uni-gjilan.net/lajmet/studentet-e-fshk-se-se-ukz-se-do-te-mund-ti-ndihmojne-komunes-se-gjilanit-ne-fushen-e-teknologjise-vekanerisht-ne-strategjine-smart-city/>), nga fusha e së drejtës (FJU, hulumtimi mbi Besueshmërinë e PK në Gjilan: <https://www.uni-gjilan.net/lajmet/stafi-akademik-dhe-studentet-e-fakultetit-juridik-kane-realizuar-hulumtimin-mbi-besueshmerine-e-policise-se-kosoves-ne-gjilan/>, fusha e edukimit (FED) dhe arsimit matematik (FSHA); duke ofruar ekspertiza dhe

shërbime të tjera profesionale për institucionet dhe shoqërinë (Komuna e Gjilanit, Gjyqësori, Shkollat, Garat e matematikës “*Kenguro 2022*”).

- **Zyra për Karrierë** ka themeluar **bazën e të dhënave** për të gjithë studentët që kanë diplomuar në UKZ, me qëllim të konsulencës së vazdueshme për studentët rreth tregut të punës, ndihmës në përgatitjen e rezumeve dhe letrave të motivimit, si dhe informimi me kohë për pozitat e hapura në ndërmarrje të ndryshme tregtare në sektorin privat dhe në atë publik.
- **Bordi Industrial Këshilldhënës** i UKZ-së ka promovuar në mënyrë të vazdueshme lidhjet akademike me industrinë dhe shoqërinë, duke shtrirë impaktin në mënyrë direkte dhe indirekte në zhvillimin e gjithëmbarshëm shoqëror. Kjo është arritur, duke bashkëpunuar me Bordin Këshillëdhënës për organizimin e takimeve, Konferencës Vjetore të UKZ-së 2022, bashkëpunitinë procese të krijimit të programeve të reja, në proceset e ri-akreditimit të programeve studimore, duke i përgatitur ato konform kërkesave të punëdhënësve potencialë, me qëllim që studentët e diplomuar më lehtë të inkorporohen në tregun e punës (Prezantimi i BPB-së për trajnime dhe për punësim të studentëve të UKZ-së (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/mundesi-trajnimi-dhe-punesimi-per-studentet-e-ukz-nga-bpb/>).

2. Objktivi strategjik: Avancimi i programeve studimore në tri nivelet e studimeve

- Për programet master të ri-akredituara dhe ato të akredituara, për herë të parë ka vazduar me sukses organizimi dhe realizimi i aktiviteteve mësimore hulumtuese **të studentëve master** në FED, FJU, FSHK, përfshirë edhe diplomimin e studentëve. Në kuadër të Fakultetit të Shkencave Aplikative janë formuar grupe të punës për zhvillimin e programeve studimore të nivelistë 5-të. Po ashtu, kanë vazduar kontaktet dhe shqyrtimi i mundësive për studimet e doktoratës me universitetet partnere.

3. Objktivi strategjik: Të rritet gjithëpërfshirja e studentëve në aktivitetet universitare dhe komunitare.

- UKZ-ja ka organizuar aktivitete, me qëllim që të térheqë nxënësit e dalluar nga arsimi i mesëm, gjithnjë duke promovuar mosdiskriminimin nacional, racor, gjinor, fetar, orientimin seksual,përkatesinë sociale apo rajonale: ditën informuese për maturantët e shkollave të mesme “Fillome një ëndërr dhe ec në të ardhmen” (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/fillo-me-nje-ide-planifiko-dhe-ec-ne-te-ardhmen/>); kampin veror të Gjilanit (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/ukz-dhe-giz-ju-fton-te-merrni-pjese-ne-kampe-verore/>); përgatitje për provimin pranues të aplikantëve të rinj (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/parlamenti-studentor-i-ukz-se-organizoi-ushtrime-vullnetare-per-aplikuesit-e-rinj-maturantet/>); konkursin për pranimin e studentëve të rinj (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/konkurs-per-pranimin-e-studenteve-te-rinj-ne-vitin-e-pare-te-studimeve-bachelor-ne-vitin-akademik-2022-2023/>). UKZ-ja ka organizuar provimet pranuese dhe proceset e tjera të pranimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj në mënyrë transparente.

- Gjatë vitit 2022 janë realizuar aktivitete për **mobilitetin e studentëve**, në kuadër të bashkëpunimit me universitetet e tjera partnerë të UKZ-së: pesëmbëdhjetë (15) studentë nga UKZ-ja janë përgjedhur për vizitë studimore njëjavore në Universitetin PH ZUG në Zvicër (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/thirrje-per-mobilitet-studentor-ne-universitetin-zug-te-zvicres/>).
- UKZ-ja ka realizuar edhe mobilitet për studentët e universiteteve të tjera në UKZ (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/ka-perfunduar-vizita-studimore-e-studenteve-te-ph-zug-ne-ukz/>) dhe promovon mobilitet të studentëve dhe stafit të UKZ-së me universitetet e tjera. UKZ-ja ka hapur thirrjen për 10 studentë për aplikime, për shkëmbim studentor në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup: (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/studentet-te-ukz-se-po-zhvillojne-vizite- studimore-ne-unt-shkup-ne-kuader-te-projektit-eviva/>). Ky shkëmbim bëhet me qëllim të marrjes së përvojave nga universitetet e institucionet e tjera jashtë vendit dhe për këtë arsy Universiteti “Kadri Zeka” i ka kushtuar vëmendje të lartë organizimit dhe punës në implementimin e projektit Erasmus+ e-VIVA.
- Thirrje për aplikime për shkëmbim studentor në Universitetin “Celal Bayar Manisa” në Turqi, në kuadër të ICM KA107 për dy studentë) <https://www.uni-gjilan.net/lajmet/thirrje-per-aplikim-per- shkembim-te-stafit-dhe-studenteve-te-ukz-se-ne-universitetin-celal-bayar-turqi-2/>; programi Erasmus+ KA107 ose shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i studentëve dhe ECTS (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit “Manisa Celal Bayar” në Turqi dhe Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan. ICM Erasmus+ mundëson shkëmbimin e studentëve nga Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan për studim dhe trajnim.
- Me aktivitete të ndryshme të studentëve në UKZ, promovohet **rritja e konkurrencës ndërmjet studentëve** për arritjen e njojurive dhe aftësive në fushat e tyre të studimeve. Diploma *student i dalluar*, e cila u ndahet çdo vit studentëve, të cilët arrijnë suksesin më të lartë në nivel të njësisë akademike (Diploma *student i dalluar* 2022: <https://www.uni-gjilan.net/lajmet/pershtypjet-e-studenteve-te-cileve-rektori-bajram-kosumi-u-dha-diplomen-student-i-dalluar-ne-pervjetorin-e-nente-te-themelimit-te-ukz-se/>); bursat universitare, të cilat ndahen për çdo vit nga UKZ-ja me konkurs të shpallur nga Këshilli Drejtues i UKZ-së në bazë të kriterieve, të cilat i cakton Senati i UKZ-së (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/konkurs-per- ndarjen-e-bursave-universitare-per-nivelin-bachelori-dhe-master-per-vitin-akademik-2021-2022/>); janë organizuar gara të ndryshme studentore dhe shpërblimi i më të mirëve, si në gjuhë dhe letërsi, matematikë, oratori, degë sportive, arte. Me rastin e përvjetorit të UKZ-së, janë ndarë edhe 5 diploma për studentët e dalluar nga 5 fakultetet e UKZ-së. Po ashtu, janë ndarë bursat universitare për studentë nga të gjitha njësitë akademike të UKZ-së.
- Turnire sportive me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/ekipi-i-studenteve-te-ukz-se-fitues-ne-turneun-e-fsuk-se-qe-u-mbajt-per-ndere-te- pavaresise-se-kosoves/>); prezantimi i hulumtimit të grupit joformal të studentëve të Fakultetit Juridik me temë “Sfidat në Parandalimin e Dhunimit Seksual (<https://www.uni->

[gjilan.net/lajmet/studentet-e-ukz-se-prezantuan-hulumtimin-sfidat-ne-parandalimin-e-dhunimit-seksual/](http://www.uni-gjilan.net/lajmet/studentet-e-ukz-se-prezantuan-hulumtimin-sfidat-ne-parandalimin-e-dhunimit-seksual/)); është organizuar trajnimi dhe certifikimi jashtëkurrikular “Kursi për programim në C# dhe Unity” (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/studentet-e-ukz-se-crtifikohen-pas-perfundimit-te-trajnimit-ne-c-dhe-unity/>); prezantimi i shfaqjeve teatrale nga studentët e UKZ-së për “Flakën e Janarit 2022” (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/ne-vigilje-te-manifestimit-gjithkombtar-flaka-e-janarit-studentet-e-ukz-kane-paraqitur-tre-shfaqje-teatrale/>); organizimi i koncertit muzikor nga kori i studentëve të UKZ-së (<https://www.uni-gjilan.net/lajmet/studentet-e-ukz-se-kane-mbajtur-koncert-perfund-vit/>).

4. Objektivi strategjik: Burimet njerëzore- zhvillimi i mëtejmë i burimeve njerëzore

- Në vitin 2022 UKZ-ja me sukses ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm dhe gjithmonë me kohë ka proceduar me procedurat e realizimit të **planifikimit të stafit akademik** dhe **administrativ**, duke filluar nga njësítë akademike nëpërmjet Këshillave të Fakulteteve; përkatësisht nga njësítë administrative, për të vazhduar me Komisionet e tjera, si: Komisionet recensuese, Komisionet për shqyrtimin e ankesave, Komisionin e Studimeve të Senatit dhe mbledhjeve të Senatit. Senati i UKZ-së gjatë vitit 2022 ka realizuar gjithsej 11 mbledhje (mbledhja e XXX më 28.01.2022, mbledhja e XXXX më 30.12.2022).
- Në muajin shkurt 2022 është proceduar me Konkursin e shpallur për Zgjedhjen/Rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik të shpallur më 22.10.2021 dhe Konkursi për Emërimin/Riemërimin e personelit të rregullt akademik në njësítë akademike të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues Nr.02/1111, dt. 08.07.2022, i shpallur më 13.07.2022. Në këto dy konkurse, u avancua personeli akademik: një (1) staf akademik nga thirrja prof.asoc.dr., në thirrjen prof.dr.; gjashtë (6) mësimdhënës të rregullt u avancuan nga thirrja prof.ass., në thirrjen prof.asoc.; tre (3) asisitentë të rregullt në UKZ u zgjodhën në thirrjen prof.ass., një (1) ligjëruese u zgjodh në thirrjen prof.ass., dhe katër (4) mësimdhënës të rinj u pranuan në marrëdhënie të rregullt pune me thirrjen prof.ass.dr.
- Zyra e Personelit sipas Planit të Personelit, ka hapur konkurs për disa pozita të lira nëadministratë në vitin 2022. Procedura e rekurtimit për katër (4) pozita është kryer me sukses dhenuk ka pasur ankesa. Aktualisht, në UKZ nëpunës të shërbimit publik janë tridhjetë e tre (33); prej tyre, drejtues i lartë një (1) nëpunës, drejtore dy (2) nëpunës, pozita udhëheqëse gjashtë (6)nëpunës dhe njëzet e katër (24) zyrtarë. Në vitin 2022 dy (2) punonjës të administratës kanë dalë në pension.
- Gjatë vitit 2022, duke qenë se UKZ-ja është pjesë e projekteve Erasmus+, në kuadër të të cilave janëzhvilluar edhe **trajnime të rëndësishme për stafin akademik dhe administrativ**; një numër i madh i stafit akademik dhe administrativ kanë realizuar trajnime të ndryshme në vend dhe jashtëvendit. Po ashtu, në këtë vit ka filluar realizimi i bashkëpunimit të UKZ-së me Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie të Universitetit të Prishtinës dhe në fillim të vitit 2023 janë realizuar trajnime për 20 mësimdhënës të UKZ-së.

5. Objktivi strategjik: Sistemi i Sigurimit të Cilësisë– sigurimi dhe ngritja e cilësisë

- Zyra për Shkencë, Zhvillim Akademik dhe Cilësi, ka koordinuar punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e ri-akreditimit të programeve, duke përfshirë të gjitha aktivitetet që përshijnë këto procese, po ashtu, koordinon punën e Zyrës me senatin e UKZ-së, Këshillin Drejtues, Njësitë Akademike, Institutet, si dhe me këshillat, komisionet dhe grupet punuese në sektorin e kërkimeve shkencore dhe çështjet e ndërlidhura.
- Në vitin 2022, si pjesë e sitemit të sigurimit të cilësisë është hartuar edhe **Kalendari Vjetor për Sigurimin e Cilësisë**. Kalendari vjetor përmban të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë më sigurim të cilësisë në UKZ. Planifikimi i aktiviteteve është bërë në baza javore, me ç'rast janë paraparë përgjegjësitet për secilin aktivitet. Kalendari i cilësisë është hartuar duke u bazuar në të gjitha rregulloret dhe dokumentet e miratuara në Senat, që kanë të bëjnë më sigurimin e cilësisë në UKZ. Përgjegjës për mbikëqyrjen e realizimin e aktiviteteve të planifikuara në këtë kalendar është ZZHAC-ja.
- **Këshilli për Mbikëqyrje të Cilësisë dhe Vlerësim (KMCV)** gjatë vitit 2022 ka mbajtur 4 mbledhje, në të cilat janë shqyrtuar monitorimi, vlerësimi dhe raportimi për cilësinë në njësitë akademike dhe të UKZ-së në tërësi (<https://www.uni-gjilan.net/aktiviteti-nderkombetar/cilesia-ne-ukz/keshilli-per-menaxhim-te-cilesise-dhe-vleresim/>).
- Në fillim të vitit akademik 2021/2022 ka filluar të implementohet **Plani i Zhvillimit Individual (PZHI)** për të gjithë stafin akademik. PZHI është një nga instrumentet e rëndësishme të cilësisë dhe vlerësimit të procesit mësimor, në të cilin ZZHAC-ja ka qasje në angazhimin e SA në procesin mësimor, angazhimin menaxherial, kërkimet shkencore dhe aktivitetet e tjera të SA-së. KMCV-ja është në proces të miratimit të Raportit të Vlerësimit të Cilësisë në UKZ.

6. Objktivi strategjik: Përmirësimi dhe promovimi/përkrashja e punës kërkimore-shkencore

- Këshilli Drejtues i UKZ-së, më datë 12.05.2022, ka miratuar **Rregulloren për Veprimtari Kërkimore-Shkencore** në UKZ (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2022/05/Rregullore-p%C3%A3Br-veprimtarin%C3%AB-k%C3%A3Brkimore- shkencore-n%C3%AB-UKZ.pdf>), në bazë të së cilës organizohet veprimtaria kërkimore- shkencore; të drejtat dhe detyrimet e organeve kompetente të Universitetit Publik "Kadri Zeka", të pjesëmarrësve të veprimitarisë kërkimore-shkencore dhe publikimin e rezultateve kërkimore- shkencore.
- UKZ-ja ka organizuar me sukses **Konferencën Vjetore të UKZ-së ACUKZ** 2023 më 30-31 maj 2022(<https://conference2022.uni-gjilan.net/>). Këshilli Organizativ i Konferencës ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme. Janë organizuar 6 sesione: sesioni plenar me temën qendrore “Identiteti Shekncor dhe Kreativiteti i Botës në Ndryshim- Scientific Identity and Creativity in a Changed World”, në të cilën kanë prezantuar personalitete të njohura shekncore nga Akademia e Shkencave të Kosovës, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Universiteti i Barcelonës (Spanjë), Universiteti i Rigës (Letoni), Universiteti i Qipros, Universiteti i Izmirit. Po ashtu, janë organizuar edhe 5 sesione paralele: “Sfidat aktuale në digjitalizim” (FSHK), “Hulumtimet aktuale në matematikë” (FSHA), “Sfidat aktuale në arsimin shkollor” (FED), “Mundësítë dhe sfidat për një ekonomi zhvillimore” (FEK), dhe sesioni “Drejtësia pozitive dhe roli i të drejtës” (FJU). Janë pranuar mbi 100 abstrakte për prezantim në Konferencë. Në kuadër të Konferencës është ndarë edhe çmimi i Konferencës me emrin ”Marin Barleti”, i cili kësaj radhe iu dha profesorit nga Universiteti i Malit të Zi,

Danilo Nikolic, i cili ka kontribuar për promovimin e UKZ-së dhe pranimin e UKZ-së në Konferencën e Rektorëve të Evropës Juglindore dhe Qendrore.

- Senati i UKZ-së, më datë 15.12.2022, me vendimin Nr.01/2739 ka themeluar **Këshillin Shkencor** të UKZ-së, bazuar në Rregulloren për Veprimitari Kërkimore–Shkencore (KSHK) (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-01-2739-per-Keshillin-SHkencor-te-UKZ-12.12.2022.pdf>). KSHK-ja ka shpallur Thirrjen për Mbështetje Financiare të punimeve shkencore të stafit akademik të UKZ-së në ueb-faqen e UKZ-së.
- Këshilli Shkencor i UKZ-së, më datën 16 dhjetor, miraton Raportin (<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2023/02/Raporti-KSHk-te-UKZ-per-vleresimin-e-PSHk-2022.pdf>) (me të cilin vlerësohen të gjitha punimet e paraqitura dhe vlerësohen për mbështetje financiare gjithsej 20 punime të publikuara në revistat e njohurandërkombëtare të indeksuara, në pltaformat e përcaktuara sipas Rregullores për Veprimitari Kërkimore-Shekncore. Janë refuzuar për arsyet ndryshme gjithsej 11 punime, ndërsa 4 kërkesajanë proceduar për shqyrtim të mëtejmë).
- Bazuar në Rregulloren për Veprimitari Kërkimore-Shkencore, Këshilli Shkencor ka proceduar edhe shpalljen e **hulumtuesit më të mirë të vitit 2022**, e cila është shpallur në ceremoninë e përvjetorit të UKZ-së.

7. Objktivi strategjik: **forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar**

- Hapësira e **bashkëpunimit ndërkombëtar** është zgjeruar edhe më tepër. Gjatë vitit 2022, UKZ-ja është bërë pjesë e disa projekteve Erasmus+ ICM.
- Janë nënshkruar një numër i konsiderueshëm i marrëveshjeve për bashkëpunim; marrëveshje ICM dhe vizita në institucionë akademike.
- Në kuadër të projekteve Erasmus+, është realizuar dhe rritur **numri i mobilitetit të stafit akademik, administrativ dhe studentëve**. Nga të gjitha njësítë akademike dhe administrative, stafi ka lëvizur në trajnime dhe vizita të ndryshme studimore, si dhe ka përfituar përvoja të reja në fushat që u përkasin.
- UKZ-ja ka bashkëpunuar me HERAS Plus për organizimin e punëtorive dhe aspekteve të tjera me rëndësi për UKZ-në.

8. Objktivi strategjik: **Përmirësimi i infrastrukturës**

- Gjatë vitit 2022 vazhduan aktivitete në drejtësim të krijimit të hapësirave të reja në objektin ekzistues, duke rinovuar disa salla mësimi dhe duke krijuar hapësira të reja për zyrtarët administrativë. Ndër to janë: rinovimin e sallës mësimore në amfiteatër; rinovimi i sallave të tjera mësimore dhe zyrave; furnizimi dhe instalimi i ashensorit në hyrjen A në UKZ; parkingu; furnizimi me pajisje të IT-së; furnizimi me printer multifunksionalë; furnizimi dhe instalimi me kamerat në UKZ.

Në përbyllje të realizimit të objktivave strategjikë, mund të përfundojmë se UKZ-ja ka punuar me sukses në realizimin e objktivave dhe nën-objktivave strategjike edhe gjatë vitit 2022.

1.2. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME STATISTIKORE të UKZ-së

Buxheti (fondet publike dhe private)


Në tabelën nr.1 është i paraqitur buxheti dhe shpenzimet deri më 31.12.2022, si dhe struktura e shpenzimeve në raport me buxhetin total:

Tabela 1. Buxheti 2022

Kategoritë Ekonomike	Buxheti për 2022 ¹	Shpenzimet 31.12.2022	Pjesëmarrja në % e shpenzimeve sipas kategorive në buxhetin total
Paga dhe Shtesa	1,630,893.95 €	1,630,324.55	99.97%
Mallra dhe Shërbime	405,432.24 €	304,928.18	75.21%
Shpenzime Komunale	50,000.00 €	15,015.18	30.03%
Subvencione dhe Transfere	100,000.00 €	70,830.00	70.83%
Pasuritë jo financiare(Kapitale)	82,030.00 €	74,759.19	91.14%
Totali	2,268,356.19 €	2,095,857.10 €	92.40%

Në vijim do të paraqesim pasqyrën grafike të buxhetit dhe realizimit të tij për periudhën reportuese (janar-dhjetor 2022)

Tabela 2. Realizimi i buxhetit 2022



Duke u bazuar në tabelën e mësipërme dhe shpenzimeve të planifikuara të UKZ-së, alokimi i këtij buxheti është bërë si në vijim (Tabela 3):

¹Buxheti final i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës– pas rishikimit të TM3.

Tabela 3. Alokimi i buxhetit 2022

Kategoritë Ekonomike	Buxheti për 2022	Alokimi i buxhetit deri më 31.12.2022	Përqindja e buxhetit të alokuar
Paga dhe Shtesa	1,630,893.95 €	1,630,893.95 €	100.00%
Mallra dhe Shërbime	405,432.24 €	405,432.24	100.00%
Shpenzime Komunale	50,000.00 €	50,000.00	100.00%
Subvencione dhe Transfere	100,000.00 €	100,000.00	100.00%
Pasuritë jofinanciare (Kapitale)	82,030.00 €	82,030.00	100.00%
Gjithsej	2,268,356.19 €	2,268,356.19 €	100.00%

Nga tabela e mësipërme shihet se buxheti në total është alokuar në lartësinë prej **100.00 %**.

Më poshtë kemi paraqitur alokimin 12-mujor të buxhetit në raport me shpenzimet e kësaj periudhe, si dhe raportin e shpenzimeve 12-mujore me buxhetin në tërësi:

Tabela 4. Alokimi 12-mujor i buxhetit 2022

Kategoritë Ekonomike	Buxheti për 2022	Alokimet	Shpenzimi	% shpenzimit në raport me alokimin 12 mujor	% shpenzimit në raport me buxhetin vjetor
Paga dhe Shtesa	1,630,893.95 €	1,630,893.95	1,630,324.55	99.97%	99.97%
Mallra dhe Shërbime	405,432.24 €	405,432.24	304,928.18	75.21%	75.21%
Shpenzime Komunale	50,000.00 €	50,000.00	15,015.18	30.03%	30.03%
Subvencione dhe Transfere	100,000.00 €	100,000.00	70,830.00	70.83%	70.83%
Pasuritë jo financiare(Kapitale)	82,030.00 €	82,030.00	74,759.19	91.14%	91.14%
Gjithsej	2,268,356.19 €	2,268,356.19€	2,095,857.10€	92.40%	92.40%

Nga shënimet e lartëkura, mund të vërehet se shpenzimet e realizuara krahasuar me alokimin e mjeteve janë bërë në lartësi prej 92.40%, që nënkupton një menaxhim të kënaqshëm për këtë periudhë kohore lidhur me shfrytëzimin e buxhetit.

Pra, Universiteti Publik “Kadri Zeka” gjatë periudhës raportuese e ka shpenzuar buxhetin në masën prej **92.40%**.

1.2.1. KATEGORTITË KRYESORE TË BUXHETIT

1.2.1.1. Paga dhe Shtesa


Në kategorinë *Paga dhe Shtesa* për periudhën raportuese 12-mujore, janë shpenzuar gjithsej 1,628,893.95€. Këtu përfshihen pagesa neto e pagave, honorarëve, mbinormave, pagesa për kontribut pensionale 5%, si dhe pagesa e tatimit të ndalur në burim për të gjithë punonjësit e rregulltë UKZ-së. Vlen të theksojmë që në këtë kategori nuk përfshihen punonjësit me kontratë për shërbimetë veçanta dhe të gjitha pagesat tjera për punonjës jashtë listës-sistemit qeveritar të pagesave (PAY ROLL). Në kuadër të kësaj vlere prej 1,628,893.95 euro, këtu janë përfshirë edhe shtesat dhe mbinormat e stafit akademik për periudhën dhjetor të vitit 2021, në vlerë prej 71,057.00 euro, të cilat janë kompenzuar në janar të vitit 2022.

Tabela 5. Pagat

Përshkrimi	Shpenzimi nga BKK
Neto pagat	1,353,670.94 €
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi	74,830.54 €
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuari	74,830.54 €
Tatimi në të hyra personale	124,141.03 €
Pagesa per sindikatë	1,420.90 €
Totali	1,628,893.95 €

Në vijim po paraqesim pasqyrën grafike për shpërndarjen e pagave bruto:

Tabela 6. Shpërndarja e buxhetit



1.2.1.2. Mallra dhe Shërbime

Në këtë kategori janë alokuar mjetet në masën prej 100.00%. Përmes kësaj kategorie janë paguar shpenzimet fiksë, ashtu edhe ato variabile si p.sh., kontratat për pastrimin-mirëmbajtjen e objektit, mirëmbajtjen e sistemeve elektronike, shërbimet kontraktuale, pagesën e mbushjeve të telefonave mobilë, avance për udhëtime zyrtare etj. Në kategorinë *Mallra dhe Shërbime*, për periudhën raportuese 12-mujore (janar–dhjetor 2022), janë shpenzuar gjithsej 304,928.18€, tabela 7.

Tabela 7. Mallra dhe Shërbime

Kategoria e shpenzimit	Totali	Përqindja %
Shërbimet e telekomunikimit- Vala (mbushjet e telefonit për menaxhmentin (8,030.00 euro) dhe faturat mujore per rrethin e administratës në UKZ (1,505.72 euro)	9,535.96 €	3.13%
Shpenzimet e internetit (mujore 441.50 euro)	5,298.00 €	1.74%
Shpenzime tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit- shpenzimet e tjera (për viza dhe sigurime, transport) (4,147.92 euro), akomodimi jashtë vendit (2,152.12 euro), meditje (2,969.00 euro), biletat e studentëve (4,470.90)	19,009.81 €	6.23%
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit (2,056.40 euro) dhe akomodimi brenda vendit (640.00 euro) për anëtarët e konferencës	3,596.40 €	1.18%
Shërbime shtypje-jo marketing	4,825.61 €	1.58%
Shërbimet kontraktuale (pagesat për 5 punëtorët e sigurimit në UKZ (11,644.40 euro), kontributet pensionale 5% për të angazhuarit (3,776.15 euro), tatimi në burim (1,665.16 euro), shujta e punëtorëve në administratë (), anëtarët e Senatit e Komisionet	29,197.17 €	9.58%
Shërbimet teknike (pagesa per sistemin elektronik të menaxhimit të studentëve SMU nga Arianit Bytyqi SHPK (38,000.00 euro), te Rexhep Syeljmani (985.00), DAS SHPK (940.00 euro), Përkthim (700.00 euro) dhe Falcon AEL SHPK (900.00 euro)	44,384.00 €	14.56%
Pajisjet tjera, mobile (IT) E-Cennect Al SHPK (10,588.80 euro), Aritech SHPK (16,220.00 euro)	27,347.30 €	8.97%
Furnizim me pije dhe ushqim (funrizimi me ujë nga kompania Ada group SHPK (939.00 euro) dhe pije e ushqim (1,046.01 euro) etj.	1,985.83 €	0.65%
Mirëmbajtja e autoveturave dhe riparimi i automjeteve	1,906.00 €	0.63%
Karburant për ngrohje	61,386.28 €	20.13%
Karburant për vetura	2,762.28 €	0.91%
Mirëmbajtja e objektit- pastrimi i objektit nga kompania Aroma Plus SHA (54,497.82euro/ mujore)	58,720.89 €	19.26%
Sigurimi fizik i objektit (2,276.83 euro/mujore)	10,625.20 €	3.48%
Furnizim për zyrë, ndërmarrja tregtare grafike Blendi (2,995.00 euro)	3,343.70 €	1.10%
Shpenzimet e reprezentacionit (Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit)	6,659.87 €	2.18%
Mirëmbatja e teknologjisë IT dhe servizimi i fotokopjeve	1,078.60 €	0.35%
Blerja e librave	3,843.88 €	1.26%
Shpenzimet për akreditim dhe anëtarësim (6,200.00) dhe anëtarësimi ATEE, AISBL (240.00) dhe European University Foundation (1,500.00 euro)	7,940.00 €	2.60%
Sigurimi i automjeteve (999.00 euro) dhe regjistrimi i automjeteve (170.00 euro)	1,169.00 €	0.38%
Mirëmbatje rutine	187.90 €	0.06%
Reklama dhe konkurse	98.00 €	0.03%
Tiketa siguruese	26.50 €	0.01%
Totali	304,928.18 €	100.00%

1.2.1.3. Shpenzimet Komunale

Shpenzimet komunale janë shpenzuar në bazë të faturave dhe përbëjnë shpenzime që ndodhin çdo muaj, thuajse në masën e njëjtë pa ndryshime të mëdha. Në këtë kategori për periudhën raportuese 12-mujore, janë shpenzuar gjithsej 15,015.18€.

Prandaj, në vijim është paraqitur tabela me shpenzime për secilin operator ekonomik.

Tabela 8. Shpenzimet Komunale

Kategoria e shpenzimit	Shuma e shpenzuar janar-dhjetor 2022
Telefonia fiksë	1,585.12 €
KEDS	11,411.70 €
HIDROMORAVA	1,438.76 €
Eco-Higjiena	579.60 €
Totali	15,015.18 €

1.2.1.4. Subvencione dhe Transfere

Me këtë kategori bëhet pagesa e bursave për studentët e dalluar, mbështetja e kërkimeve dhe publikimeve shkencore për stafin akademik, si dhe aktivitete të ndryshme, si gara dhe recitime nga studentët.

Në këtë kategori për periudhën raportuese 12-mujore, janë realizuar shpenzime në vlerë prej 70,830.00€.

Tabela 9. Subvencione dhe Transfere

Subvencione	janar-dhjetor 2022
Bursa të studentëve (77 studentë kanë përfituar bursë)	61,600.00 €
Punimet shkencore, Koferanca etj.	9,230.00 €
Totali	70,830.00 €

1.2.1.5. Shpenzimet kapitale

Për vitin 2022, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në kategorinë kapitale ka buxhetin e ndarë në vlerë prej 82,030.00€. Kjo kategori posedon 3 projekte kapitale, si në vijim:

- Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së UKZ-së në shumë prej 48,030.00€,
- Blerja e mobilieve në UKZ në shumë prej 20,000.00 euro, si dhe
- Blerja e pajisjeve laboratorike dhe të teknologjisë informative në shumë prej 14,000.00€.

Më poshtë kemi edhe tabelën sipas strukturës së shpenzimit të mjeteve kapitale:

Tabela 9. Struktura e Mjeteve Kapitale

Nr.	Projekti	Shuma	Shpenzimi	Përqindja%
1	Ndërtimi dhe rinovimi i infrastrukturës së UKZ-së -14039	48,030.00 €	47,915.69 €	99.76%
2	Blerja e mobileve në UKZ- 14047	20,000.00 €	17,108.50 €	85.54%
3	Pajisje të IT-së- 15256	14,000.00 €	9,735.00 €	69.54%
	Totali	82,030.00 €	74,759.19 €	91.14%

1.2.1.6. Të hyrat vetanake²

Universiteti “Kadri Zeka” për periudhën raportuese janar–dhjetor 2022, ka krijuar të hyra vetanake prej **50,452.50 euro-** Participimet e studentëve të UKZ-së.

Tabela 10. Të hyrat vetanake

Të hyrat vetanake	janar-dhjetor 2022
Janar	3,575.00 €
Shkurt	1,873.50 €
Mars	11,593.50 €
Prill	2,218.00 €
Maj	710.50 €
Qeshor	5,029.00 €
Korrik	2,777.50 €
Gusht	465.00 €
Shtator	1,205.00 €
Tetor	14,502.50 €
Nëntor	3,587.50 €
Dhjetor	2,915.50 €
Totali	50,452.50 €

1.2.1.7. Të hyrat nga Projektet Erasmus+

Universiteti “Kadri Zeka” është pjesë aktive e 9 projekteve në Erasmus+ CBHE; 1 si grant-mbajtës/koordinatator dhe 5 si partner.

Gjatë vitit 2022 UKZ-ja ka vazhduar zbatimin e projekteve në kuadër të **ERASMUS+**, shih Tabela 11:

² Universiteti “Kadri Zeka” nuk i shfrytëzon-menaxhon të hyrat vetanake, pasi ato inkasohen në buxhetin e MASHT-it.

Tabela 11. Të hyrat nga projektet

Akronimi	EMËRTIMI	Koordinator	Buxheti	Kohëzgjatja	Të hyrat janar –shtator 2022	Shpenzimet janar–shtator 2022
QUADIC	Quality development of international cooperation and project management- Ngritja e kapaciteteve në bashkëpunim ndërkombëtar dhe menaxhim të projekteve	Universiteti “Kadri Zeka”	29,834.00€	36 muaj 15/01/2020 15/01/2023	0.00 €	112,522.21 €
E-VIVA	Enhancing and Validating service related competences in Versatile learning environments in Western Balkan Universities- Ngritja dhe validimi i kompetencave në shërbim	Universiteti Evropian i Tiranës	56,075.00€	36 muaj 15/11/2018 15/11/2021	0.00 €	10,160.00 €
SIAHDPC		Kolegji Heimerer	89,010.00€		0.00 €	11,993.53 €
SMAHPC	Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center- Krijimi i Qendrës Multidisiplinare për studentë	Kolegji Heimerer	73,115.00€	36 muaj 15/11/2018 15/11/2021	0.00 €	6,810.00 €
ResearchCult	Enhancing Research Culture in Higher Education in Kosovo- Ngritja e kulturës së hulumtimit në IAL në Kosovë	Kolegji IBCM	53,440.00 €	36 muaj 15/11/2019 15/11/2022	12,955.60 €	12,002.33 €
ENEMLOS	Legal clinics in service of vulnerable groups: enhancing the employability of law students through practical education- Ngritja dhe funksionalizimi i klinikave ligjore në universitetet partnerë përmes edukimit në praktikë	Universiteti i Podgoricës	90,586.00€	36 muaj 15/11/2019 15/11/2022	33,813.87 €	24,995.16 €
STAND		Koordinator UP	95,865.00€		0.00 €	32,739.41 €
QATEK	Towards a quality oriented system of initial teacher education to increase teacher professionalism in Kosovo- Ngritja e cilësisë së mësimit te stafi dhe studentët në fakultetet e edukimit	Universiteti i Prishtinës	95,865.00€	36 muaj 15/11/2019 15/11/2022	0.00 €	37,884.00 €
STEAMedu	MSc course in STEAM education	Universiteti i Mostarit	6,406.02€	15/01/2020 15/01/2023	0.00 €	6,406.02 €
Totali			683,790.00€		46,769.47 €	255,512.66 €

1.2.2. Personeli (shifrat zhvillimore)

Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan ka personelin akademik dhe administrativ. Në kuadër të personelit akademik hyn i gjithë stafi i rregullt akademik, profesorët dhe asistentët.

Universiteti Publik “Kadri Zeka” ka:

- 47 profesorë në marrëdhënie të rregullt pune (Prof.Dr., Prof. Asoc., Prof.Ass.Dr.), 1 ligjërues dhe 1 asistente, gjithsej 49 punonjës, staf i rregullt akademik.

Gjatë vitit 2022 në Fakultetin e Edukimit janë pranuar:

- tre (3) mësimdhënës, sipas konkursit të shpallur në nivel të UKZ-së,
- në Fakultetin e Shkencave Komputerike është pranuar një (1) mësimdhënës, sipas konkursit të shpallur në nivel të UKZ-së.

Në vitin 2022, dy (2) mësimdhënës, personel akademik kanë dalë në pension.

Për më shumë, shih Tabelën 12.

Shënim: do të përdoren shkurtesat; Fakulteti i Edukimit- FED, Fakulteti Juridik- FJU, Fakulteti Ekonomik-FEK, Fakulteti i Shkencave Komputerike-FSHK, Fakulteti i Shkencave Aplikative-FSHA.

Shih: *Tabela 12. Personeli akademik*

Nr.	Emri dhe mbiemri	Konkurs I	Konkurs II	Konkurs III	Konkurs I	Konkurs II	Fusha e studimit
1	Prof. Dr. Bajram Kosumi	25.09.2015	30.09.2019		15.02.2021	E përhershme	Filologji dhe gazetari
2	Prof. Asoc. Dr. Shpresa Qamili	01.10.2014	30.09.2018	Procedura shtyre për 1 vit (2019)	01.10.2019	30.09.2023	15.02.2026
3	Prof. Asoc. Dr. Fejzullah Hasani	01.10.2014	30.09.2018	Procedura shtyre për 1 vit (2019)	01.10.2019	30.09.2023	14.02.2026
4	Prof. Dr. Xhevdet Thaqi	01.10.2014	30.09.2018		15.02.2022	E përhershme	Matematikë (didaktikë e shkenca eksperimentale dhe matematikë)
5	Prof. Ass. Dr. Gëzim Tosuni	01.10.2014	30.09.2018	Procedura shtyre për 1 vit (2019)	01.10.2019	30.09.2023	Ekonomi (makroekonomi)
6	Prof. Asoc. Dr. Arben Mustafa	01.10.2014	30.09.2018	Procedura shtyre për 1 vit (2019)	01.10.2019	30.09.2023	15.02.2026
7	Prof. Asoc. Dr. Sadik Haxhiu	01.10.2014	30.09.2018	26.03.2019	01.04.2019	31.03.2023	Juridik (kushtetuese)
8	Prof. Asoc. Dr. Lutfi Zharku	01.10.2014	30.09.2018	Procedura shtyre për 1 vit (2020)	01.10.2019	30.09.2023	14.02.2026
9	Prof. Ass. Dr. Teuta Agaj	01.10.2014	30.09.2017	01.10.2018	30.09.2021	26.08.2023	Ekonomi (financa)
10	Prof. Ass. Dr. Mensur Neziri	01.10.2014	30.09.2017	01.10.2018	30.09.2021	26.08.2023	Juridik (kushtetuese)
11	Ass. Afërdita Ibrahimini	01.10.2014	30.09.2017	01.10.2018	30.09.2021	30.09.2022	Pedagogji (kurrikula)
12	Prof. Ass. Dr. Fatmine Krasniqi	01.10.2014	30.09.2017	01.10.2018	30.09.2021	01.10.2020	Sh. kompjuterike
13	Prof. Ass. Dr. Arbenita Kosumi	01.10.2014	30.09.2017	01.10.2018	30.09.2021	30.09.2024	Juridik (penale)
14	Prof. Ass. Dr. Detrina Alishani	01.10.2014	30.09.2017	01.10.2018	30.09.2021	30.09.2022	30.09.2026
15	Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi	01.10.2014	30.09.2017	01.10.2018	30.09.2021	26.08.2023	Ekonomi (banka financa)
16	Prof. Ass. Dr. Arben Sahiti	01.10.2014	30.09.2017	01.10.2018	30.09.2021	15.02.2021	Juridik (civile)
17	Prof. Ass. Dr. Lulzim Rashiti	01.10.2014	30.09.2017	01.10.2018	30.09.2021	30.09.2022	14.02.2025
18	Prof. Asoc. Dr. Naim Mustafa		15.02.2016	14.02.2020	01.10.2020	30.09.2024	Ekonomi (marketing)

Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan- Raporti Vjetor i Punës 2022

19	Prof. Asoc. Dr. Musa Ajeti		15.02.2016	14.02.2020	01.10.2020	30.09.2024	Matematikë-statistikë (geometri diferencale)
20	Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka		15.02.2016	14.02.2020	01.10.2020	30.09.2024	Juridik (ndërkombëtare)
21	Prof. Asoc. Dr. Nevrije Ismajli		15.02.2016	14.02.2020	01.10.2020	30.09.2024	Filologji (letërsi)
22	Prof. Asoc. Dr. Mershjan Avdyli		15.02.2016	14.02.2020	01.10.2020	30.09.2024	Filologji (letërsi)
23	Prof. Asoc. Dr. Basri Ahmedi		15.02.2016	14.02.2020	20.10.2020	30.09.2024	Shkencë kompjuterike (rijeta kompjuterike)
24	Prof. Asoc. Dr. Ragmi Mustafa		15.02.2016	14.02.2020	20.10.2020	30.09.2024	15.02.2022 14.02.2026 Shkencë kompjuterike (sistemi ikontrollit dhe Teknologjisë)
25	Prof. Ass. Dr. Lindita Hyseni		15.02.2016	14.02.2019	01.10.2019	26.09.2023	Shkencë kompjuterike (sistemet e informacionit)
26	Prof. Asoc. Dr. Ekrem Halimi		15.02.2016	14.02.2020	20.10.2020	30.09.2024	Matematike (analizë dhe algebër)
27	Prof. Asoc. Dr. Urtak Hamiti			15.02.2017	14.02.2021		Juridik (ndërkombëtare)
28	Prof. Asoc. Dr. Xhevhat Sopi			05.12.2016	04.12.2020		Ekonomi (menaxhment)
29	Prof. Asoc. Dr. Arjan Dëmaku			01.05.2018	30.04.2022		Shkencë kompjuterike (algoritmet euristike në mekatronikë dhe robotikë, aspektet softuerike)
30	Prof. Ass. Dr. Bashkim Dalipi			15.02.2017	14.02.2021		Shkencë natyrore (fizikë)
31	Ph.D.C. Ahmeti Ibrahim, Ligi			05.12.2016	04.12.2020		Fakulteti i Arteve të Btkura (arte)
32	Prof. Ass. Dr. Selim Daku			01.10.2020	30.09.2024		Juridik (ndërkombëtare)
33	Prof. Ass. Dr. Nexhat Shkodra			15.02.2021	14.02.2025		Ekonomi (makroekonomi)
34	Prof. Ass. Dr. Voglushe Kurteshi			26.08.2019	26.08.2023		Pedagogji
35	Prof. Ass. Dr. Bajram Fejzullahu			26.08.2019	26.08.2023		Ekonomi, (Menaxhment dhe Ndërmarrësi)
36	Prof. Ass. Dr. Shefqet Jakupi			26.08.2019	26.08.2023		Ekonomi (Menaxhment dhe Ndërmarrësi)
37	Prof. Ass. Dr. Kastriot Dërmaku			26.08.2019	26.08.2023		Shkençat Kompjuterike (Teknologji Informative)
38	Prof. Ass. Dr. Albulena Hajdari-Krasniqi			26.08.2019	26.08.2023		Juridik, (Shkencë Juridike)
39	Prof. Ass. Dr. Fadil Osmani			26.08.2019	26.08.2023		Pedagogji
40	Prof. Ass. Dr. Arbona Xhemajli			01.10.2021	30.09.2025		Ekonomi
41	Prof. Ass. Dr. Art Shala			01.10.2021	30.09.2025		Ekonomi, Banka dhe Financa
42	Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj			01.10.2021	30.09.2025		Histori
43	Prof. Ass. Dr. Ardian Emini			01.10.2020	30.09.2025		

44	Prof. Ass. Dr. Nerxhiane Krasniqi					01.10.2019	30.09.2023			Psikologji-Pedagogji
45	Prof. Ass. Dr. Dritë Kryeziu Musmuratii							01.10.2022	30.09.2022	Shkencë Sociale, Psikologji-Pedagogji
46	Prof. Ass. Dr. Shqipe Avdiu Kryeziu	01.10.2022	30.09.2026							Pedagogji
47	Prof. Ass. Dr. Flamur Maloku	01.10.2022	30.09.2026							Leterzi i dhe Gjuhe Shqipe
48	Prof. Ass. Dr. Sylej Uksimi	14.11.2022	30.09.2026							Histori i dhe Marrëdhënie Nderkombëtare
49	Prof. Ass. Dr. Liridon Hoti	01.10.2022	30.09.2026							Sisteme dhe Teknologji Informatike Informatikë dhe Shkenca Kompjuterike

Në përgjithësi, numri i stafit akademik të rrëgullt dhe të angazhuar, si dhe personeli administrativ sipas njësive akademike dhe gjinisë, është paraqitur si në vijim:

Tabela 13: Numri i stafit akademik dhe administrativ sipas gjinisë 2021/2022

Fakulteti/Programi i studimit	Të rrëgullt		Të angazhuar		Staff tjefër (administrativ)	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Fakulteti i Edukimit	7	7	9	10		
Fakulteti Ekonomik	2	12	7	5		
Fakulteti Juridik	4	8	7	13		
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	2	7	4	9		
Fakulteti i Shkencave Aplikative			2	5		
Administrata Qendrore- Rektorati	0	0	0	0	19	14
Gjithsej	15	34	29	42	19	14

Në administratë, në vitin 2022 konkursi i hapur ka qenë për katër (4) pozita në procedurën e rekrutimit; procesi i rekrutimit është kryer me sukses dhe nuk ka pasur ankesa. Aktualisht, në UKZ nëpunës të shërbimit publik janë tridhjetë e tre (33):

- drejtues i lartë- një (1) nëpunës,
- drejtorë- dy (2) nëpunës,
- pozita udhëheqëse- gjashtë (6) nëpunës dhe
- njëzet e katër (24) zyrtarë.

Në vitin 2022, dy (2) punonjës të administratës kanë dalë në pension.

Zyra e Personelit ofron ndihmë teknike komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, lidhur me procedyrat e rekrutimit; plotësim të dosjeve në SIMBNJ; kërkesa të pushimit vjetor dhe pushimeve të tjera për të gjithë punonjësit përmes sistemit SIMBNJ; plotësim i dosjes së nëpunësve të ri dhe rifreskim i dosjeve prezentë; plani i personelit për vitin 2022 në SIMBNJ; trajnime në IKAP, MPB, janë zhvilluar këto tema të trajnimeve:

- Procesi i Klasifikimit të Vendeve të Punës për Zyrtarët Publikë (MPB)
- Menaxhimi dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore (IKAP)
- Trajnimi dhe Zhvillimi i Nëpunësve Civilë (IKAP)
- Siguria në Punë (IKAP)
- Trajnimi Hyrës për Nëpunësit e Ri Civilë në Shërbimin Civil të Kosovës (IKAP)
- Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian (BE), (IKAP)
- Procesi Politik, Korniza Ligjore dhe Praktikat e Negocimit (IKAP)
- Standardet/Kapitujt në Çështjet e Politikës së Jashtme (IKAP)
- Standardet/Kapitujt në Çështjet e Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (IKAP)

Numri total i stafit akademik dhe administrativ të rregullt dhe të angazhuar është si në tabelën në vijim.

Tabela 14: Stafi akademik dhe administrativ

Stafi		
Stafi i rregullt akademik Gjithsej: 49	Profesorë në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	47
	Asistentë në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	1
	Ligjërues në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	1
Stafi angazhuar akademik Gjithsej: 71	Profesorë të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	12
	Ligjërues të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	2
	Asistentë të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	57
Administratë	Administratë	33
	Gjithsej	153

1.2.3. INFRASTRUKTURA

Infrastruktura është një burim kyç për zhvillimin e aktiviteteve arsimore dhe punëve administrative ditore në një universitet. Infrastruktura e mirë dhe qasja e lehtë në mjesiset e të mësuarit; salla mësimi, leximi, zyra shërbimi, i hap rrugën përparimeve shkencore dhe krijimit të njofturive të UKZ-së.

UKZ-ja do të vazhdojë të punojë që të zhvillojë infrastrukturë të mirë arsimore për të mbështetur dhe kontribuar në zhvillimin e arsimit. Kjo kërkon një perspektivë afatgjatë, që merr parasysh strategjitet ekzistuese të brendshme.

Infrastruktura e UKZ-së është infrastrukturë mesatare dhe i plotëson kushtet minimale të nevojshme për mbajtjen e ligjératave dhe kryerjen e shërbimeve përkatëse për çdo njësi akademike dhe administrative. Secila sallë mësimi është e pajisur me projektor dhe secila zyrë është e furnizuar me materialin e inventarin e nevojshëm përkatës. Çdo hapësirë është e mbuluar me internet (WiFi); falë projektit KODE-KREN në partneritet me Bankën Botërore dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Objekti kryesor ka një hapësirë prej 6900 m² për zyrat e stafit akademik dhe administrativ; sallat e mësimit, laboratorët, kabinetet, bibliotekën dhe infrastrukturën tjetër të paraqitur në tabelën 1 dhe 2, ndërsa komplet Kampusi i UKZ-së gjithsej ka një hapësirë prej 2 ha ose 20000 m².

UKZ-ja bashkë me Komunën e Gjilanit dhe me Qeverinë e Kosovës, ka planifikuar zgjerimin e kampusit aktual me një objekt të madh ose ndërtimin edhe të një kampusi të ri në tjetër pozicion. Për këtë qëllim, Komuna e Gjilanit ka ndarë në vitin 2014 vendin e duhur prej 7.3 ha, përkatësisht në vendin ku aktualisht qëndron FSK-ja. Ky projekt nuk është realizuar asnjëherë, pavarësisht angazhimit të UKZ-së dhe pavarësisht premtimeve të qeverive, për arsyet e interesave afatgjata të FSK-së.

Gjatë vitit 2022 menaxhmenti i UKZ-së ka bërë përpjekje për gjetjen e një zgjidhje të re; ka gjetur një vend të ri, i cili menaxhohet nga Agjencia e Kosovës për Privatizim, në një hapësirë prej rreth 13 ha dhe në pajtim me kryetarin e Komunës së Gjilanit, ka kërkuar nga MASHT-i të ndërmarrë masat e duhura që kjo parcelë të hiqet nga lista e shitjes dhe të dërgohet vendim-propozimi në Qeveri, që kjo parcelë t'i jepet UKZ-së për shfrytëzim. MASHT-i i ka shkruar letër rektorit se do ta procesojnë kërkesën, por deri më sot ende nuk jemi të njoftuar se cilat veprime janë ndërmarrë.

Tabela 15: Zyrat e menaxhmentit, akademik, administrativ, parlamentit studentor dhe depos

Zyrat	Nr. i zyrave	Hyrja A	Hyrja B
Zyra e Këshillit Drejtues	1	Kati I	
Zyrat e Menaxhmentit	5	Kati I- Rektorati	
Zyrat e Dekanëve	5	Kati I, II	Kati P,I,II
Zyrat e Stafit Akademik	19	Kati I, II,III	Kati P, I, II
Zyrat e Stafit Administrativ	19	Kati P, I, II	Kati P, I,
Zyra e Parlamentit Studentor	1		Kati II
Depo	3	Kati nëntokësor-P	

Tabela 16: Sallat e mësimit, kabinetet e informatikës dhe laboratorët

Hyrja A		Hyrja B	
Salla Nr.	Nr. i ulëseve	Salla Nr.	Nr. i ulëseve
A/01	72	Amfiteatër i vogël (B/01)	94
A/02	92	B/02	78
A12	67	B/03	40
Klasa e dedikuar për parashkollor (A/14)	32	Salla e Informatikës/Laborator i rrjeteve kompjuterike (B/10)	15
A/21	41	B/11	107
A/22	80	Salla e Informatikës (B/12)	30
A/23	37	B/21	113
A/25	54	B/22	49
A/33	30	B/23	25
Laboratori i Shkencave Natyrore (A/13)	47	Salla e Informatikës/Laborator i rrjeteve kompjuterike (B/24)	31
Salla e Arteve (A/26)	30	Salla e Informatikës B/31	27
Kabineti i Muzikës (A/24)	56	Gjithsej	609
Salla e Konferencave (A/34)	70		
Salla e Leximit	250		
Salla mësimi A/27	57		
Salla mësimi	30		
Gjithsej	1045		

1.2.3.1. Raporti i Prokurimit

Sipas Ligjit të Prokurimit, zyra e prokurimit është kompetente vetëm për udhëheqjen e procedurave të prokurimit deri në nënshkrimin e kontratës, por jo edhe për përgatitjen e specifikave dhe kërkesave të njësive kërkuese. Njësitë kërkuese për t’i realizuar propozimet e tyre që i kanë paraparë me data në plan të prokurimit, duhet të përgatitin kërkesën se cilin aktivitet dëshirojnë ta iniciojnë dhe së bashku me kërkesë t’i bashkëngjesin edhe specifikimet teknike, në mënyrë që zyra e prokurimit të bëjë gati dosjen e tenderit.

Më datë 28.12.2021 është dërguar Plani Përfundimtar i Prokurimit për vitin 2022, për përgatitjen e specifikave, me ç’rast për secilin aktivitet kanë qenë të vendosura propozimet e prorekторëve, dekanëve për procedurat, të cilat duhet të zhvillohen.

Nga data 01.01.2022 deri më 24.02.2022, nuk kemi mundur të zhvillojmë procedura të prokurimit, pasi sistemi SIMFK (Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës) ka qenë i bllokuar.

Zyra e Prokurimit nga muaji mars i vitit 2022 ka zhvilluar gjithsej 34 procedura të prokurimit, me ç’rast prej tyre 26 janë procedura me vlerë minimale (deri 1000 euro), 2 prej tyre vlerë e vogël (deri 10.000 euro) dhe 6 janë me vlerë të mesme (mbi 10.000 euro).

Procedura me vlerë më të vogël se 10.000 euro:

- Furnizim me libra për UKZ-në; vlera e kontratës është 3,843.88 euro, operatori ekonomik fitues është NT “ABETARJA” nga Gjilani.
- Furnizim me printer multifunksional; kontrata është lidhur më datë 02.12.2022 në vlerë prej 9,885.00 euro.

Procedura me vlerë mbi 10.000 euro që janë iniciuar :

- Rinovimi i zyreve dhe tualeteve në UKZ; vlera e kontratës është 22,866.09 euro, operatori ekonomik fitues është “L-GROUP” nga Prishtina. Ky aktivitet ka përfunduar me sukses, njësi kërkuese, prorektori Bajram Fejzullahu.
4.	Bashkautor Fadil Osmani	Employment According to Sectors and Socioeconomic Activities, with a Focus on Gender Equality, Brings an Increase in the Social and Economic Well-Being of Kosovo	Sejdiu, S., Gaxhiqi, B., Nimani, A., Osmani, F. Journal of Educational and Social Research this link is disabled, 2022, 12(5), pp.96–107 https://www.researchgate.net/publication/363243228_Employment_According_to_Sectors_and_Socioeconomic_Activities_with_a_Focus_on_Gender_Equality_Brings_an_Increase_in_the_Social_and_Economic_Well-Being_of_Kosovo https://www.richtmann.org/journal/index.php/jesr/article/view/13070 RICHTMAN-SCOPUS
5.	Sadik Haxhiu &Fadil Osmani	Financimi i partive politike dhe fushatave elektorale në disa shtete të Evropës Juglindore (Monografi)	Botoi: Instituti për Studime Ligjore dhe Demokratike, Gjilan, 2022. ISBN: 978-9951-9024-3-4
6.	Fatmire Krasniqi	Criminal etiology of juvenile delinquency(Eziologia criminale della delinquenza minorile)	Rassegna Italiana di Criminologia, N. 2 (2022), Volume XVI, numero 2, anno 2022, PUBBLICATO: 2022-06-30, indeksuar në platformën SCOPUS Q2
7.	Fatmire Krasniqi& Gëzim Jusufi	Tax evasion as a criminal offense in developing countries: Some perception from business organizations	Corporate Governance and Organizational Behavior Review/Volume 6, Issue 4, Special Issue, 2022 Indeksuar në platformën SCOPUS

Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan- Raporti Vjetori Punës 2022

	Ramic-Brkic, A. Vujovic, B.Boskovic, A.Idrizi, M.Pasic, A.Vatres, Dukagjin Leka		SCOPUS: https://www.scopus.com/authid/detail.uri?authorId=57205162064
17.	Avni H. Alidemaj, Sadik HAXHIU	Reforming administrative law in transition countries kosovo context	Balkan Social Science Review DOI: https://doi.org/10.46763/BSSR2219107a Vol. 19 (2022): https://js.ugd.edu.mk/index.php/BSSR/issue/view/BSSR2219
18.	Sadik Haxhiu	Financial expenses of montenegrin election Campaigns and political parties	Universiteti shtetëror i Tetovës; International Congress on Human, Social Sciences and Arts; 16 – 18 November, 2022 https://sites.google.com/unite.edu.mk/faculty-of-law/?pli=1
19.	Dukagjin Leka, Selim Daku, Gezim Jusufi	Regional Cooperation and Free Trade Agreements in Western Balkans: Opportunities and Obstacles	International Journal of Sustainable Development and Planning Vol. 17, No. 7, November, 2022, pp. 2239-2246 Journal homepage: http://iieta.org/journals/ijspd https://doi.org/10.18280/ijspd.170724 Indexed in scopus

FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA

Tabela 45: Lista e punimeve shkencore të stafit akademik të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara gjatë vitit 2022

Nr.	Autori/ët:	Titulli i punimit:	Revista, numri/viti, vendi i botimit; mefaktor impakti; statusi i revistës
1.	Prof. Asoc. Dr. Shpresë Qamili	Managing Autonomous Learning in Higher Education: Transnational Experiences in Comparison, Learning through International Exchanges in Teacher Education, Dec 20, 2022	https://doi.org/10.5281/zenodo.7377613 Zurich University of Teacher Education, Zurich, OpenAire
2.	Prof. Dr. Xhevdet Thaqi	The Structure of n Harmonic Points and Generalization of Desargues' Theorems MDPI-Mathematics, 2022	https://doi.org/10.3390/math9091018 -Scopus, -Web of Science -SCIE
3.	Prof. Dr. Xhevdet Thaqi	.Different Ways of Conceptualizing Mathematical Content for Prospective Primary School Teachers IGI Global: International Journal of Smart Education and Urban Society (IJSEUS), 2022.	Volume 12, Issue 1, 61-68 -World cat; -ACM Digital Library -Cabell's Directories; -DBLP; -ERIH -Google Scholar
4.	Prof. Asoc. Dr. Musa Ajeti	1.Quasi-Cartesian Compositions In Affine Space Connection, Four Dimensional Without Tensor	https://doi.org/10.37418/amsj.10.2.33 Impact Factor 1.726

Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan- Raporti Vjetori i Punës 2022

8.	Fatmire Krasniqi, Saranda Leka & Gëzim Jusufi	Crime and firm performance: Empiricalevidence from the balkan region	Corporate & Business Strategy Review / Volume 3, Issue 2, Special Issue, 2022. Indeksuar në platformën SCOPUS
9.	Egzonis Hajdari & Albulena Hajdari- Krasniqi & Ibrahim Omer	Same-sex relationships- the absence of legislative framework in the Republic of Kosovo	International Comparative Jurisprudence, Vilnius, Lithuania, Vol. 8, no.1 (2022), Jun 21, 2022, Scopus, https://ojs.mruni.eu/ojs/international-comparative-jurisprudence/article/view/7130
10.	Ardian Emini	Blood feud in “Leke Dukagjini Code” (kanunii lekë dukagjinit) and its impact in the contemporary law in albania and kosovo	Vol 12, No 4 (2022) The Lawyer Quarterly, Institute of State and Law of the Academy of Sciences of the Czech Republic, Scopus Q3.
11.	Ardian Emini	The basis for changing the maintenance (assistance) measure for children– the case of separation of parents in the republic of kosovo	Vol 12, No 3 (2022) The Lawyer Quarterly, Institute of State and Law of the Academy of Sciences of the Czech Republic, Scopus Q3
12.	Abdula Azizi, Sabiha Shala, Dukagjin Leka	Analysis of Government Measures for Economic Support in the Covid-19 Pandemic Crisis: The Case of NorthernMacedonia	Journal of Economic and Social Studies Volume 8 Issue 1 JEL Classification: G01, H84, I18 https://jecoss.ibu.edu.ba/assets/jecoss/vol8-is1/Paper%20ID%2080.%201%20in%20order.edited.pdf Web of Science: https://www.webofscience.com/wos/woscc/full-record/WOS:000781569700001
13.	Sabiha Shala, Dukagjin Leka* *Corresponding author	The right to an effective education: live legal clinics as an innovative teaching method	Int. J. Innovation and Learning, Vol. 31, No. 1,2022 https://www.inderscienceonline.com/doi/pdf/10.1504/IJIL.2022.119634 SCOPUS: https://www.scopus.com/authid/detail.uri?authorId=57205162064
14.	Dukagjin Leka, Gezim Jusufi	Regional Cooperation and Free Trade Agreements in Western Balkans: Opportunities and Obstacles	International Journal of Sustainable Development and Planning, 2022, 17(7), pp. 2239–2246, DOI: https://doi.org/10.18280/ijspd.170724 SCOPUS: https://www.scopus.com/authid/detail.uri?authorId=57205162064
15.	Fadil Osmani Dukagjin Leka* Gezim Jusufi	Regional economic cooperation in the western balkans: promoter or inhibitor of eu integration of this region	Advances in Business Related Scientific Research Journal, 2022, 13(1), pp. 68–89 https://www.absrc.org/wp-content/uploads/2022/06/PAPER-Jusifi.pdf SCOPUS: https://www.scopus.com/authid/detail.uri?authorId=57205162064
16.	M. Pasic, K.Çabiri, B. Vucijak, J.S. Jovanovic, M. Milojkovic, B.	Service related competences education practices in South East Europe	International Journal for Quality Research 16(2) 515–540 ISSN 1800-6450 UDC– 37.011.2:37 DOI – 10.24874/IJQR16.02-12 http://ijqr.net/journal/v16-n2/12.pdf

Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan- Raporti Vjetori i Punës 2022

		Advances in Mathematics: Scientific Journal 10(2022), No.2, 1053–1063 ISSN: 1857-8365 (printed); 1857-8438 (electronic)	
5.	Prof. Asoc. Dr. Musa Ajeti	2. Weyl Spaces Of Compositions Of Six Basic Manifolds ADV MATH SCI JOURNAL	https://doi.org/10.37418/amsj.10.10.5 Impact Factor 1.726
6.	Prof. Asoc. Dr. Ekrem Alimi	Weighted $(E\lambda, q)(C\lambda, 1)$ -Statistical Convergence and Some Results Related to This Type of Convergence Publisher: MDPI, Journal: Symmetry, V.14/ Issue 11/Symmetry 2022, 14(11), 2363;	https://doi.org/10.3390/sym14112363 -Scopus -Web of science/SCIE
7.	Prof. Asoc. Dr. Ekrem Alimi	Statistical weighted $(N\lambda, p, q)(E\lambda, 1)$ - summability with application to Korovkin's type approximation theorem Publisher: Elsevier, Journal: Bulletin des Sciences Mathématiques, Volume 178, September 2022, 103146	https://doi.org/10.1016/j.bulsci.2022.103146 -Scopus -Web of science/SCIE
8.	Prof. Asoc. Dr. Ekrem Alimi	Rate of Weighted Statistical Convergence for Generalized Blending-Type Bernstein-Kantorovich Operators, Publisher: MDPI, Journal: Mathematics, V. 10/ Iss 12/ 2022, 10 (12), 2027	https://doi.org/10.3390/math10122027 -Scopus -Web of science/SCIE

Tabela 46. Lista e pjesëmarrjes në konferenca dhe punëtori të ndryshme

Nr.	Autori/ët:	Titulli:	Konferenca/Projekti:
1.	Shpresë Qamili	Writing scientific research articles/papers	ResearchCult
2.	Shpresë Qamili	EBSCO and Plagiarismcheck	ResearchCult
3.	Shpresë Qamili	Cikli i menaxhimit të Projektit (CMP)	HERAS+
4.	Shpresë Qamili	Successfully implementing and applying for Erasmus+ International Mobilities in Higher Education	HERAS+
5.	Shpresë Qamili	Monitorimi i zbatimit të planit strategjik	HERAS+
6.	Shpresë Qamili	Workshop on Horizon Europe Project Proposal Writing	HERAS +
7.	Shpresë Qamili	Hulumtimi shkencor dhe publikimi në revista shkencore	HERAS +
8.	Shpresë Qamili	Moderatore e sesionit “Education in the early childhood & TS03”	17th International Interdisciplinary Conference “The role of Technology in the Shaping of Society”; 11-12 November, 2022, Gjilan
9.	Shpresë Qamili	Metodat e avancuara të mësimdhënies dhe hulumtimi e publikimet shkencore	UGJFA
10.	Shpresë Qamili	Dëgjimi publik për Projektligjin Nr.08/L-110, pjesëmarrje dhe kontribut për Agjencinë e Kosovës për Akreditim	6 prill 2022

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Tabela 47: Lista e pjesëmarrjes në konferenca dhe punëtori të ndryshme

Autori/ët:	Titulli i punimit:	Revista, numri/viti, vendi i botimit; me faktor impakti; statusi i revistës
1. A.Dermaku	Participating to : ATMAE Accreditation 101, Self-study report training and Visiting Team Membertraining. Certificated as accreditaionexpert	ATMAE- The Association of Technology, Management and Applied Engineering #1019, 6207 Route 30 Suite 1027, Greensburg, PA 15601, USA Conference, https://www.atmae.org , November, 2022
2. A.Dermaku S.Maloku	Detection and recognition of texts from images through Machine Learning Models using " TensorFlow" - Case study: Application for automation of payment slips with inUKZ	UKZ Annual Conference 2022, May 30-31, 2022, Gjilan, Conference Paper-DigiDay
3. A.Dermaku B.Bajrami	Dynamic presentation of the teaching timetable on Big Screen- Case study Computer Science Faculty Schedule	UKZ Annual Conference 2022, May 30-31, 2022, Gjilan, Conference Paper-DigiDay
4. A.Dermaku B.Bajrami L.Alimi	Control of Parking Ramp through smart applications	UKZ Annual Conference 2022 May 30-31, 2022, Gjilan, Conference Paper-DigiDay
5. A.Dermaku B.Kurti D.Dalipi	Software for real-time registration of students evidence	UKZ Annual Conference 2022 May 30-31, 2022, Gjilan, Conference Paper-DigiDay
6. Ekrem Alimi	Weighted $(N,p,q)(E,1)$ -statistical convergence relating with statistical summability of sequences of fuzzy numbers	5th International Conference on Mathematical Advances and Applications" - 11-14 May 2022 (ICOMAA-2022), www.icomaas.com
7. Ekrem Alimi	Weighted $(E_\lambda, q)(C_\lambda, 1)$ -Statistical Convergence and some results related to this type of convergence	UKZAC-2022 – Scientific Identity and Creativity in a Changed World, 30- 31 May 2022, Gjilan-Kosovë https://conference2022.uni-gjilan.net/
8. Ekrem Alimi	Weighted $(N,p,q)(E,q)$ Ideal Convergent Sequence Spaces	6th International Students Science Congress- 20-21 May 2022, www.sciencecon.org
9. Ekrem Alimi	Statistical weighted Cesaro-Euler A-summability with application to Korovkin's type approximation theorem	Western Balkan Conference on Mathematics and Applications 1-3; September 2022, Prishtine, Kosove http://wbcma2022.ilirias.com
10. Ekrem Alimi	Some new result and application of weighted statistical Norlund-Cesaro A-Summability	1-st ISCPMA, 03 – 04 November 2022, Elbasan-Albania www.uniel.edu.al https://www.uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-te-natyres/njoftime/1380-1-st-international-
11. Xhevdet Thaqi	Challenges in Mathematics Education Research: Past, Present and Future	UKZ AC2022 – MathDay Conference, 31 May 2022, Gjilan, Kosovë UKZ Conference 2022 - Book of Abstract (uni-gjilan.net)
12. Xhevdet Thaqi Besim Berisha	The Trajectories of the Construction of Mathematical Concepts	17th Annual International Conference “The role of Technology in the Shaping of Society”, November 2022, Gjilan, Kosovë, Proceedings gjilan 2022.pdf - Google Drive

Tabela 53: Punimet e publikuara

Nr.	Autori/ët:	Titulli i punimit:	Revista, numri/ viti, vendi i botimit; me faktorim pakti; statusi i revistës
1.	Basri Ahmedi	The application of a socio-economic indicator for calculating the bandwidth of a backbone in a WAN. DOI: 10.4018/IJICTHD.295560	International Journal of Information Communication Technologies and Human Development, Vol 14, Issue 1, Article 2, 18 shkurt, 2022 https://www.worldcat.org/title/9426421863
2.	Basri Ahmedi, Xhevdet Thaqi, Ragmi Mustafa	Separate jobs of three types of users for better functioning of e-Lerning in UKZ DOI:10.4018/IJSEUS.291710	International Journal of Smart Education and Urban Society (IJSEUS), Vol 13, Issue 1, Article 1, 25 shkurt, 2022 https://www.worldcat.org/title/9433973212
3.	N.Demaku, A.Dermaku	Improving Load Balancing and Scalability by Implementing PathSelection on BGP Using Multi SD-WAN	Journal of Communications, 2022, 17(4), pp.250–259 SCOPUS / Article, JournalMetrics= 1.9
4.	Basri Ahmedi, Xhevdet Thaqi, Ragmi Mustafa	Separate jobs of three types of users for better functioning of eLerning in UKZ DOI: 10.4018/IJSEUS.291710	International Journal of Smart Education and Urban Society (IJSEUS), Vol 13, Issue 1, Article 1, 25 shkurt, 2022, https://www.igi-global.com/journals/openaccess/table-of-contents/international-journalsmart-education-urban/188335 https://www.worldcat.org/title/9433973212
5.	Ekrem Alimi, Penpark Sirimark, Astrit Ramizi, Agon Mahmuti	Weighted $(E\lambda, q)(C\lambda, 1)$ -StatisticalConvergence and Some Results Related to This Type of Convergence	Publisher: MDPI, Journal: Symmetry Volume 14/ Issue 11/ <i>Symmetry</i> 2022, 14(11), 2363; https://doi.org/10.3390/sym14112363 Indeksimi: Scopus, 1-rst Quartile, Web of science SCIE Journal Impact Factor 2021, 2.94 Journal Impact Factor Five Year, 2.834
6.	H.M. Srivastava, Ekrem Alimi, Bipan Hazarika	Statistical weighted $(N\lambda, p, q)(E\lambda, 1)$ -summability withapplication to Korovkin's type approximation theorem	Publisher: Elsevier Journal: Bulletin des Sciences Mathématiques Volume 178, September 2022, 103146 https://doi.org/10.1016/j.bulsci.2022.103146 Indeksimi: Scopus, 3-rd Quartile Web of science SCIE
7.	Faruk Ozger, Ekrem Alimi (autor korrespondent), Merve Temizer Ersoy	Rate of Weighted Statistical Convergence for GeneralizedBlending- Type Bernstein- Kantorovich Operators	Publisher: MDPI, Journal: Mathematics Volume 10/ Issue 12/ <i>Mathematics</i> 2022, 10(12), 2027; https://doi.org/10.3390/math10122027 Indeksimi: Scopus, 1-rst Quartile Web of science, SCIE
8.	Basri H. Ahmedi, Xhevdet Thaqi, Ragmi Mustafa	Separate Jobs of Three Types of Users for Better Functioning of E-Learning in UKZ	International Journal of Smart Education and Urban Society (IJSEUS) DOI: 10.4018/IJSEUS.291710 Në proces të indeksimit në Web of Science https://www.igi-global.com/article/separate-jobs-of-three-types-of-users-for-better-functioning-of-e-learning-in-ukz/291710

1.2.7.2. Conferencia/Tryeza

UKZ-ja organizon dhe bashkorganizon ngjarje të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare, të cilat informojnë studentët, stafin dhe komunitetin më të arriturat; trendet e zhvillimit të arsimit, bashkëpunimin dhe projektet, konferanca, simpoziumet, trajnime, me anë të së cilave zhvillon stafin. Të gjitha NJA dhe administrative bashkëpunojnë ngushtë në implementimin e ideve dhe projekteve që ndihmojnë në zhvillim profesional:

- **Konferencia Vjetore UKZ-2022 – Scientific Identity and Creativity in a Changed World.** Konferanca ka zhvilluar punimet në një Sesion Plenar dhe 5 sesione paralele të mbajtur në hapësirat e Universitetit, ku ka ofruar pjesëmarrje me prezantime të rezultateve të kërkimit në Konferencën DiGiDay/Sfidat aktuale në digitalizim, në Konferencën e MathDay/ Kërkimet aktuale në matematikë, në Konferencën EduDay/Sfidat aktuale në arsimin shkollor, në Konferencën e Ekonomisë /Mundësitë dhe sfidat për zhvillimin ekonomik në BB, si dhe në Konferencën e Drejtësisë/Drejtësia pozitive dhe shteti ligjor. Në Konferencën Vjetore Shkencore Ndërkombëtare “Identiteti Shkencor dhe Kreativiteti në një Botë të Ndryshuar”, organizuar nga Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, është dhënë edhe Çmimi i Konferencës Vjetore të UKZ-së “Marin Barleti”. Pas propozimit të Këshillit Organizativ të Konferencës dhe me vendim të Rektorit të UKZ-së, Prof. Dr. Bajram Kosumi, çmimi i Konferencës Vjetore të UKZ-së “Marin Barleti” i është dhënë **Prof. Dr. Danilo Nikolic** nga Universiteti i Malit të Zi.
- **Konferencat e Rektoreve në Kosovë.** Universitetet Publike në Kosovë kanë organizuar Konferencën e Rektorëve, me anë të së cilës do të diskutohen çështjet e rëndësishme rreth Arsimit të Lartë në Kosovë dhe probleme që ballafaqohen këto universitete. Konferencia e Rektoreve ka dalë më disa rezoluta dhe reagime për çështje të ndryshme, të cilat kanë prekur direkt Universitetet dhe Arsimin e lartë në Kosovë. Udhëheqës i kësaj Konference janë Rektorët, të cilët këtë funksion e ushtrojnë me rotacion. Tani UKZ-ja ka marrë udhëheqjen e kësaj Konference. UKZ-ja gjatë vitit 2021 ka qenë udhëheqëse e Konferencës së Rektoreve.
- **Konferencia Ndërkombëtare,** organizuar nga Albanian Sociological Association, Institute of Sociology, Demographic research and Innovation, Universiteti “Kadri Zeka”, tema: “Roli teknologjisë në modelimin e shoqërisë”.
- **Konferencia Cluster Meeting në Prishtinë 2022.** Në organizim të Komisionit Evropian dhe Zyrës së Erasmus+ në Prishtinë, është organizuar Konferencia me temë: "Financial issues of Erasmus+ Capacity Building Higher Education (CBHE) projects on reform and modernisation of Higher Education system in Kosovo". Cluster Meeting, Universiteti Publik “Kadri Zeka”, u përfaqësua nga Profesori Ekrem Halimi, i cili prezantoi projektin e UKZ-së Erasmus+ “QUADIC” dhe rezultatet e tij të implementimit, projekt i cili ka arritur të ngrisë kapacitetet në dy fusha të rëndësishme për universitetet në Kosovë dhe Shqipëri- Ndërkombëtarizimin dhe Projektet.
- **Bashkorganizimi i Konferencës Ndërkombëtare** “Arsimi dhe kultura në shoqërinë bashkëkohore” (Education and Culture in Contemporary Society) në nëntor 2021. Në dy ditët e organizimit të kësaj Konference janë prezantuar punime, me ç'rast UKZ-ja do të jetë organizatore e Konferencës së radhës në vitin 2022.
- Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, ka organizuar **tribunën– JANARI I PËRFLAKUR**. Në shënimin e përvjetorëve të rënieve të viganëve të kombit tonë, pishtarëve të lirisë, Kadri Zeka, Jusuf

Gërvalla, Rexhep Mala, Nuhi Berisha e Bardhosh Gërvalla, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan ka organizuar tribunën – **JANARI I PËRFLAKUR**.

- Përfaqësuesit e Dhomave të Specializuara të Kosovës **mbajtën ligjératë** në UKZ. Me qëllim të informimit të studentëve lidhur me funksionimin, organizimin dhe juridiksonin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Gjykatën Speciale në Hagë, në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, para studentëve të Fakultetit Juridik është mbajtur ligjératë nga Përfaqësuesit e DHSK-së. Kjo ligjératë ishte në bashkorganizim të Fakultetit Juridik të UKZ-së, Organizatës YIHR, si dhe organizatës partnere lokale, Vullnetarët e Qytetit.
- UKZ-ja pjesë e **forumit të Rektorëve të Universiteteve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor**. Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar Dukagjin Leka së bashku me Dekanin e Fakultetit Ekonomik Xhevati Sopi, profesorin Selim Daku dhe asistentin Lulzim Rashiti, kanë marrë pjesë në forumin e gjashtë të Rektorëve të Universiteteve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor, që u mbajt në Universitetin e Beogradit.
- Fakulteti Juridik i UKZ-së pjesë e **Kongresit Ndërkombëtar të Shkencave Humane, Sociale dhe Arteve**, mbajtur në UT Tetovë. Fakulteti Juridik i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, ka qenë bashkorganizatorë në Universitetin e Tetovës, nga data 16 deri më 18 nëntor 2022, me ç'rast i ka zhvilluar punimet Kongresi Ndërkombëtar i Shkencave Humane, Sociale dhe Arteve, që kanë marrë pjesë 485 hulumtues shkencorë nga 25 njësi akademike. Brenda këtij Kongresi u organizuan 5 Konferenca Shkencore. Fakulteti Juridik i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan ishte bashkorganizator i Konferencës së 7-të Shkencore Ndërkombëtare me Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës dhe me Fakultetin Juridik të UHZ-së. Në këtë konferencë nga Fakulteti Juridik i UKZ-së, me punime shkencore morën pjesë 20 profesorë dhe asistentë rregullt dhe të angazhuar. Punimet më të përzgjedhura të Konferencës do të botohen në revista shkencore, të indeksuara në platformën SCOPUS.

1.2.8. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Universiteti “Kadri Zeka” mbetet i përkushtuar në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjes në projekte, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe zhvillimit akademik të stafit akademik, administrativ dhe studentëve. Në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Universitetit “Kadri Zeka” janë arritur rezultate të mëdha dhe të rëndësishme në fushën e bashkëpunimit dhe projekteve në programe të ndryshme që ofron Bashkimi Evropian dhe organizata të tjera. Mekanizmat që UKZ-ja ka ndërtuar garantojnë një përfshirje intensive në ngjarjet ndërkombëtare; përfshirë aktivitetet shkencore, hulumtuese, kërkimore, projektet ndërkombëtare dhe mobilitetet.

Ky raport përfshin në detaje projektet, marrëveshjet e bashkëpunimit, vizitat studimore, trajnimet online, vizitat monitoruese, info days etj.

Marrëveshjet bilaterale të bashkëpunimit

Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan gjatë vitit 2022 ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me 4 universitete rajonale dhe evropiane, si dhe me 5 institucione publike apo private:

- Çukurova University– Adana/Turkey;
- University of Economics and Human Sciences– Poloni;
- Qendra “Shkolla e Drejtoreve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar” – Tiranë/Shqipëri;
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë –Tiranë/Shqipëri;
- Inovation Center Kosovo(ICK)–Prishtinë/Kosovë;
- Komuna e Gjilanit–Gjilan/Kosovë;
- Qendra e Trajimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC)– Prishtinë/Kosovë;
- University of Applied Sciences in Nysa–Poloni;
- Anadoly University–Turkey;

Marrëveshjet janë realizuar falë angazhimit të zyrës në gjetjen e partnerëve të rinj dhe bashkëpunimit të mëparshëm gjatë projekteve ndërkombëtare. Ky bashkëpunim do të vazhdojë edhenë të ardhmen, sipas pikave të marrëveshjeve të arritura.

Projektet ndërkombëtare

Universiteti “Kadri Zeka” është pjesë aktive e projekteve ndërkombëtare Erasmus+, Heras +, Banka Botërore, US Grants, Qeverinë zvicerane, Swiss Caritas.

UKZ-ja është pjesë ë këtyre projekteve në ERASMUS+ CBHE:

- QUADIC (Koordinator);
- QATEK;
- ENEMLOS;

Raporti Vjetor i Punës 2022– Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan

- SIAHDPC;
- ResearchCult;
- STAND,
- e-VIVA;
- SMAHPC;
- STEAMedu;
- WEBJOU– Erasmus+;
- SUSWELL– në pritje të konfirmimit.

Me programin e HERAS, është pjesë aktive e të gjitha thirrjeve dhe punëtorive, projekteve të vogla të saj. Në kuadër të Heras, gjithashtu, janë organizuar edhe trajnime të ndryshme, me ç'rast HERAS mbështet UKZ-në me expertë të jashtëm për hartim të strategjisë 2023-2027.

Në kuadër të ICM ERASMUS+:

- University of Ruse – Bullgari;
- Anadoly University – Turqi;
- Manisa Celal Bayar University– Manisa/Turqi;
- University of Applied Sciences in Nysa– Poloni;
- Kastamonu University– Turqi;
- Univerisdad de Jaen– Spanjë;
- Nova Lisbona– Portugali.

Të dhënët për mobilitetin e stafit akademik, administrativ dhe studentëve, në kuadër të projekteve, si dhe në kuadër të ICM (International Credit Mobility).

Tabela 54. Mobiliteti i stafit

Projekti CBHE/ICM	Numri	Periudha	Vendi
Enemlos	Staf 4	2022	Zagreb
Quadic	Staf 4	2022	Perugia
Smahpc	Staf 5	2022	Finlandë
Siahdpc	Staf 5	2022	Finlandë
Vizitë në Gent University	Staf 3	2022	Gent/Belgjikë
ResearchCult	Staf 4	2022	Bullgari
Quadic	Staf 4	2022	Bullgari
ICM – MCBU - Incoming	Staf 1	2022	Manisa/Turqi
Enemlos	Staf 4	2022	Poloni
Quadic	Studentë 4	2022	Pejë
ICM – MCBU - Incoming	Studentë 3	2022	Gjilan/Kosovë

Raporti Vjetor i Punës 2022 – Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan

E-viva	Studentë 8	2022	Maqedoni
ICM – MBCU - Outgoing	Studentë 4	2022	Manisa/Turqi
Enemlos	Staf 5	2022	Angli
Quadic	Staf 4	2022	Sloveni
Quadic	Staf 4	2022	Francë
Stand	Staf 4	2022	Itali
Forumi e 6-të i Rektorëve të Universiteteve të Evropës Jug-lindore dhe Ballkanit Perendimor	Staf 4	2022	Beograd/Serbi
ICM – MCBU - Outgoing	Staf 4	2022	Turqi
ICM - Univerisdad de Jaen	Staf 2	2022	Spanjë
Shkëmbim/exchange PH Zug në UKZ - Incoming	Studentë 10	2022	Gjilan/Kosovë
Stand	Staf 2	2022	Mal të Zi
Quadic	Staf 4	2022	Shqipëri
Shkëmbim/exchange UKZ në PH Zug - Outgoing	Studentë 15	2022	Zug/Zvicër

Projekti Erasmus+ QUADIC

UKZ-ja është koordinatore e projektit QUADIC. Edhe në vitin 2022, ky projekt ka vazhduar me implementimin e punëve që rrjedhin nga përshkrimi i tij. Janë realizuar disa vizita studimore dhe punëtori nëpër universitetet partnere.

- Punëtoria e realizuar për zhvillimin e Rrjetit për Bashkëpunim Rajonal në kuadër të projektit Quadic,në Universitetin Teknik të Sofjes.
- Punëtoria triditore (3) për zhvillimin e Rrjetit për Bashkëpunim Rajonal, që ka për qëllim lehtësimin e bashkëpunimit në mes të universiteteve rajonale dhe ndërkombëtare.
- Katër studentë të Universitetit "Kadri Zeka" kanë përfunduar trajnimin e organizuar nga Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, në kuadër të Projektit QUADIC, të cilin e koordinon UKZ-ja.
- Trajnim i paraparë për studentë me temën Menaxhimi i Projekteve dhe Internacionizimi, mblodhi në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë shumicën e partnerëve, të cilët ndihmojnë UKZ-në në implementimin e Projektit QUADIC, i cili përfshin gjithsej 17 partnerë.
- Studentët punuan në grupe të përbashkëta në realizimin e detyrate të ndryshme, të cilat burojnë nga projekti në fjalë, me theks të veçantë në aftësimin e tyre për menaxhimin e projekteve dhe internacionalizimin e institucioneve përkatëse.
- Punëtoria në kuadër të projektit ERASMUS+ QUADIC është mbajtur në Universitetin e Lubjanës, e cilaka për qëllim arritjen e impaktit të dëshiruar në dy fushat që mbulon projektin Ndërkombëtarizimin dhe Menaxhimin e Projekteve. Punëtoria në kuadër të projektit QUADIC e mbajtur në Lubjanë të Sllovenisë.
- Në Université Côte d'Azur të Nices (Francë) është mbajtur punëtoria në kuadër të projektit Erasmus+Quadic. Punëtoria ka vazhduar për katër (4) ditë dhe gjatë saj trajtohen çështje, si strategjitet e bashkëpunimit ndërkombëtar, projektet ndërkombëtare, duke përfshirë hartimin dhe menaxhimin e tyre, si dhe gjetjen e partnereve për mobilitet akademik dhe hulumtim.
- Në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë është realizuar punëtoria mbi ndërkombëtarizimin e institucioneve të arsimit të lartë. Në kuadër të projektit QUADIC është mbajtur punëtoria, e cila ka për trajtesë mundësitet e rritjes së përfshirjes ndërkombëtare të IAL-ve; mundësive që Unioni Evropian ofron për rrjetizim dhe fonde, programet e veçanta sikurse Horizon Europe, ndërtimi i bashkëpunimeve me partnerë strategjikë dhe përfshirja në rrjete ndërkombëtare të IAL-ve.
- Në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë u realizua punëtoria për qasjet e reja ndaj ndërkombëtarizimit dhe implikimet e tyre në strategjitet e universiteteve.
- Është realizuar trajnimi treditor (3) në kuadër të Projektit ERASMUS+ “QUADIC”. Dita e parë e trajnimit u mbajt në Universitetin e Prishtinës, ku u diskutua për ndërkombëtarizimin dhe projektet- rasti i UP, ndërsa dy ditët e radhës trajnimi është realizuar në Kolegjin Heimerer dhe në Kolegjin UBT.
- Në Universitetin Evropian të Tiranës është zhvilluar trajnimi për forcimin e kapaciteteve të

Raporti Vjetor i Punës 2022– Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan IAL-ve për intensifikim të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zhvillim te projekteve, me ç'rast ishin pjesë dhe përfaqësues nga tetëmbëdhjetë (18) IAL nga Kosova, Shqipëria dhe shtetet e Unionit Evropian.

Projekti Erasmus + STAND

Projekti STAND synon të rrisë autonominë e universitetit në Kosovë. Ai kërkon të zhvillojë dhe azhurnojë si menaxhimin dhe qeverisjen e universiteteve të Kosovës, ashtu edhe kapacitetet e autoriteteve kombëtare për të modernizuar sistemet e tyre të arsimit të lartë, duke mbështetur zhvillimin e modeleve adekuate të autonomisë, zbatimin dhe monitorimin e politikave të reformës në autonominë e universitetit.

- Punëtoria e organizuar në Universitetin e Fogjas të Italisë, në kuadër të projektit "Strengthening University Autonomy and Increasing Accountability and Transparency of WBU", pjesëmarrës ishin një grup i stafit akademik dhe administrativ i UKZ-së.
- Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, ka pranuar pajisje teknologjike në vlerë mbi 27,791.00€ nga projekti Erasmus+STAND (Strengthening university autonomy and increasing accountability and transparency of Western Balkans Universities). Pajisje si TV Samsung 4K, Laptop, Interactive whiteboard IR, Projektor ViewSonic VP, PC etj.

Projekti Erasmus+ QATEK

Projekti QATEK, i cili ka për qëllim futjen e mekanizmave përsigurimin e cilësisë në IAL në Kosovë; për të zbatuar praktika të brendshme të sigurimit të cilësisë që çojnë drejt ngritjes së cilësisë së diplomuarve, të cilët janë të aftë të çojnë përpëra reformën e shkollës. Qëllimet specifike të këtij projekti janë: zhvillimi i mekanizmave dhe proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë brenda institucioneve të arsimimit të lartë në Kosovë, të cilat i përgjigjen treguesve specifikë të cilësisë; zhvillimi i kapaciteteve për menaxhimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë në arsimimin e mësuesve nëpër Fakultetet e Edukimit, duke përfshirë miratimin e politikës së personelit të FE dhe politikën e hartimit të lëndëve; zhvillimi i kapaciteteve të stafit akademik në ofrimin e cilësisë së mësimdhënies si një nga treguesit në mekanizmin e brendshëm të cilësisë; zbatimi i një procesi të plotë të sigurimit të cilësisë për të gjitha fushat përkatëse të edukimit të mësuesve (zbatimi i lëndës, rëndësia e programit, programi hulumtues, bashkëpunimi ndërkombëtar, shërbimet e studentëve, praktikat administrative dhe të menaxhimit).

Janë realizuar këto aktivitete:

- Takim koordinues në kuadër të Projektit QATEK, mbajtur në UP, konkretisht në Fakultetin e Edukimit, njëherit edhe koordinatorin e Projektit QATEK për Kosovë.
- Universiteti Publik “Kadri Zeka” ka pranuar një numër librash për bibliotekën e UKZ-së. Këto libra janë të gjitha për Fakultetin e Edukimit dhe janë përfituar nga projekti Erasmus+ QATEK. Librat do të shfrytëzohen nga studentët e profesorët e FE dhe të gjitha janë botim i pesë viteve

Raporti Vjetor i Punës 2022– Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan
të fundit.

- Në kuadër të projektit “Drejt një sistemi të orientuar të cilësisë së edukimit fillestar të mësuesve për të rritur profesionalizmin e tyre në Kosovë”, “QATEK”; njohësit e edukimit nga universiteti italian “LUMSA”, zhvilluan punëtorinë tërëditore në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, me modulin “Dimensioni shoqëror i edukimit”, brenda programit “Ngritura e Kapaciteteve për Mësimdhënësit”.
- Staf i UKZ-së ishte pjesëmarrës në simpoziumin për zhvillimin e mësimdhënësve të rinj. Simpoziumi me temë: “Zhvillimi i mësimdhënësve të rinj: sfidat dhe e ardhmja”, në kuadër të projektit Erasmus+ “Drejt një sistemi të orientuar në cilësi të përgatitjes së mësimdhënësve të rinj në Kosovë” (QATEK), nën udhëheqjen e Fakultetit të Edukimit në Prishtinë.

Projekti Erasmus+ SIAHDPC

Ky projekt do të krijojë edhe lidhje të reja dhe më të forta bashkëpunimi midis "trekëndëshit" të arsimit, kërkimit dhe industrisë për nivele më të larta të efektivitetit dhe mekanizmave të financimit. Projekti do të mundësojë zhvillimin e njohurive në teknologji dhe njohuri të reja për kërkimin dhe zhvillimin. Po ashtu, do të krijohen qasje të adaptuara pedagogjike e të favorshme për zhvillimin e mendimit kritik dhe të krijimtarisë. Një numër i madh i trajnimeve do të mundësojnë stafit dhe studentëve më të mirë, që të trajnohen për përfshirjen e përdoruesve, inovacionin e sipërmarrjen, praktikën e informuar nga dëshmitë e bashkëpunimin ndërdisiplinor, së bashku me industrinë, klientët dhe aktorë të tjera relevantë.

Të dhënat mbi mobilitetin e stafit akademik dhe administrativ:

- Vizita studimore në Universitetin JAMK në Finlandë;
- Dy punëtori në Kolegjin Heimerer rrëth paketave punues WP4 dhe WP3;
- Janë realizuar të gjitha detyrat nga ana e UKZ-së deri në këtë fazë.

Projekti Erasmus + e-VIVA

Projekti e-VIVA është projekt në partneritet më Universitetin Evropian të Tiranës dhe me nga dy partnerë nga secili shtet i Ballkanit Perëndimor e partnerë nga Evropa, i cili ka të bëjë me validimin e kompetencave të studentëve në shërbime. Nga ky projekt do të përfitojnë direkt 30 studentë nga UKZ-ja, të cilët do të trajnohen dhe do të licencoohen me licenca të njohura ndërkombëtarisht.

Janë realizuar këto aktivitete:

- Konferenca transnationale e Projektit e-VIVA në Tiranë dhe takimi i fundit i menaxhmentit të projektit. Studentët tanë kanë prezantuar projektin e tyre në këtë konferencë, projekt ky që është punuar gjatë vizitës dyjavore të tyre në Universitetin ”Nëna Tereza” në Shkup. Tetë (8) studentët ishin pjesë e shkëmbimit dyjavor (2) në Universitetin mik nga Maqedonia Veriore.

Raporti Vjetor i Punës 2022– Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan

Projekti Erasmus+ SMAHPC

Projekti SMAHPC është projekt në partneritet me gjashtë partnerë kosovarë dhe tre partnerë evropianë, i cili ka për qëllim krijimin e Qendrave Multidisiplinare për studentë që ofrojnë shërbime, të cilat janë duke u implementuar me sukses. Koordinator i këtij projekti është Kolegji Heimerer.

Janë realizuar këto aktivitete:

- Në Universitetin "Kadri Zeka" është mbajtur prezantimi i raportit mbi pilotimin e kurseve të mbajtura gjatë vitit të kaluar akademik, në kuadër të projektit Erasmus Plus #SMAHPC. Në punëtorinë e mbajtura u zhvillua sesion i reflektimit për procesin e pilotimit, përfshirjen e studentëve, prezantimin e koncepteve të reja të përdorura, qasjet metodologjike, protokollet, modelet dhe praktikat më të mira. Në punëtori morën pjesë përfaqësues nga Universitetet Metropolia dhe JAMK nga Finlanda, Universitetit të Manisa-s në Turqi, Universitetit të Gjakovës, Kolegjit Heimerer dhe OJQ Autizmi nga Kosova. Prezentimi i rezultateve të arritura në trajnimin në kuadër të projekteve SMAHPC dhe SIAHDPC
- Gjatë këtyre dy ditëve janë prezantuar të arriturat e të dy projekteve, me theks të veçantë ato të projektit SMAHPC, i cili është edhe në fazën finale të tij, me ç'rast Universiteti "Kadri Zeka" ka hapur qendrën e multidisiplinare brenda UKZ-së, të cilën e udhëheqin studentët. Janë pilotuar lëndë nëpër fakultete të ndryshme prej profesorëve të ndryshëm me teknika të ndryshme, të cilat kanë rezultuar në avancimin dhe ndryshimin e syllabuseve për aq sa është e lejuar.
- Është realizuar PMG dhe SC meeting në kuadër të projektit SMAHPC, në Universitetin Celal Bayar në Manisa/Turqi. Ky ishte një prej takimeve të fundit të PMG pasiqë projekti SMAHPC është në vitin e fundit të implementimit të tij.
- Asistenti Refik Ramadani si pjesë e projektit SMAHPC nga Universitetit Publik "Kadri Zeka", në emisionin "Pas Dite" në RTK ka paraqitur të arriturat e projektit SMAHPC.

Projekti Erasmus+ ResearchCult

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ResearchCult është të mbështesë rritjen e kulturës së kërkimit në IAL në Kosovë, duke mbështetur zhvillimin e politikave e praktikave të mira, krijimin e instalimin e rregulloreve, strukturave e mekanizmave të rinj në institucionet përfituese të projektit në Kosovë.

Janë realizuar këto aktivitete:

- Stafi nga Universiteti Publik "Kadri Zeka" kanë marrë pjesë në punëtorinë në kuadër të projektit ResearchCult në University of National and World Economy në Bullgari, ku u diskutua për rregulloren për etikën dhe integritetin në kërkimin shkencor, për të cilën stafi i UKZ-së ka mbajtur takime edhe në UKZ, ku ka përpiluar një draft në të dy gjuhët, atë shqipe dhe angleze.
- Në Universitetin e Prishtinës është realizuar trajnimi për shkrimin e artikujve shkencor, në

Raporti Vjetor i Punës 2022– Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan kuadër të projektit ResearchCult. Trajnim i treditor (3) që ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit akademik të institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë, për shkrimin e artikujve shkencorë. Në këtë trajnim, përvojat e tyre i ndanë profesoer dhe hulumtues nga Sapienza Università di Roma dhe Università per Stranieri di Siena.

- Në kuadër të kësaj vizite, u mbajt edhe mbledhja e Quality Board Meeting.

Projekti Erasmus+ ENEMLOS

Projekti synon zhvillimin profesional të studentëve të Fakultetit Juridik në UKZ dhe universitetet e tjera në Kosovë. Ky projekt do të jetë me një rëndësi të madhe në Kosovë, sepse ka mungesë të praktikës në studimet e Fakultetit Juridik. Studentët përfundojnë fakultetin e tyre të drejtësisë dhe ende ka mundësi që të mos kenë praktikë deri në fund të fakultetit të tyre.

Janë realizuar këto aktivitete:

- punëtoria treditore(3) për klinikat ligjore, e cila u zhvillua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit. Qëllimi i punëtorisë është transmetimi i përvojave në themelimin dhe funksionimin e klinikave ligjore nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Zagrebit te partnerët kosovarë. Universiteti Publik "Kadri Zeka" është partner dhe koordinator i projektit për Kosovë.
- Punëtoria për klinikat juridike në Warsaw të Polonisë.
- Punëtoria në Londër, në Regent's University London "RUL". Përzgjedhja e studentëve, të cilët do të jenë pjesë e klinikës ligjore brenda Universitetit Publik "Kadri Zeka", në kuadër të projektit ENEMLOS.
- Tjetër takim i realizuar me kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Gjykatësin z. Venhar Salihu dhe gjykatësit z. Ramiz Azizi dhe z. Rilind Sermaxhaj, për të bashkërenduar aktivitetet lidhur me projektin për klinikat ligjore në UKZ.
- Takimi i menaxhmentit të projektit ERASMUS+ “ENEMLOS”, në Universitetin e Zagrebit.
- Takimi i Quality Board Meeting në kuadër të projektit ENEMLOS në Universitetin e Podgoricës.

Projekti Erasmus+ STEAMedu

Projekti STEAMedu ka për qëllim forcimin e arsimit në Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, arte dhe matematikë (STEAM), duke promovuar programin studimor të bivelit master STEAMed. Koordinar i projektit është Universiteti i Mostarit (Bosnia dhe hercegovina). Në kuadër të projektit synohet përgatitja e një udhërrëfyesi për të adresuar zhvillimin e një eko-sistemi arsimor STEAM në zhvillim, duke përfshirë edhe krijimin e një programi studimor Master (MSc), shërbimet e bashkëpunimit me palët e interesit dhe në procedurat e vlerësimit vazhdueshëm. Janë organizuar dy vizita virtuale studimore, të cilat për shkak të pandemisë Covid-19 janë realizuar online.

Janë realizuar këto aktivitete:

- Janë finalizuar raporte me rëndësi për hartimin e kurrikulave nga fusha e STEAM.

66 | P A G E

Raporti Vjetor i Punës 2022– Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan

- Është finalizuar përbajtja dhe syllabuset e lëndëve për programit studimor STEAMedu. Në këto punëtori, konsorciumi ka miratuar një qasje hibride, duke lidhur me këtë kërkimin, aktivitetet dhe palët e interesit, të cilët janë të gatshëm të kontribuojnë drejt universiteteve partnere dhe objektivat e BE-së për vitin 2020.

Projekti SHPRESE me Swiss Caritas

Në vitin 2022 projekti SHPRESE ka vazhduar ma aktivitetet e veta:

- Universiteti "Kadri Zeka" University u vizitua nga dy përfaqësuesit e kontraktuar nga Caritasi Zviceran, znj. Tuija Stenback dhe z. Gazmend Tahiraj, për vlerësimin e projektit "SHPRESE", projekt i cili implementohet nga "Swiss Caritas" në bashkëpunim me fakultetet e edukimit si partnerë shumë të rëndësishëm të projektit në fjalë.
- Ceremonia përmbyllëse e projektit SHPRESE, me Caritasin Zviceran.

Projektet dhe punëtoritë me HERASPlus

Bashkëpunimi mes UKZ-së dhe Heras ka vazhduar edhe në vitin 2022.

Më poshtë do të gjeni aktivitetet mbajtura.

- Punëtoria e realizuar në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan mbi masat e ndërhyrjes strategjike për të përmirësuar pozicionin në renditjen webometrike të universiteteve botërore.
- Grup i stafit nga UKZ-ja ishin pjesëmarrës në trajnimin "Successfully implementaion and applying for Erasmus+ International Mobilities in Higher Education". Zbatimi dhe aplikimi me sukses për Erasmus+ International Mobilities në Arsimin e Lartë, i organizuar në kuadër të projektit HERAS. Ky trajnim synon t'u ofrojë ekspertë në sektorin e Arsimit të Lartë të Kosovës dhe atyre që janë në rrugë për t'u bërë një me njohuri teorike dhe praktike në skemën e financimit të mobilitetit Erasmus+. Objktivi kryesor është forcimi i projekteve të mobilitetit për studentët dhe stafin universitar në Kosovë.
- Një grup nga stafi akademik dhe administrativ nga Universiteti Publik "Kadri Zeka" kanë marrë pjesë në trajnimin dyditor (2) "Project Management Cycle- PMC" të organizuar në kuadër të projektit HERAS.

Vizita të ndryshme në institucione partnere

Mobiliteti në Universitetin "Celalbayar Bayar" në Manisa të Turqisë

Ekipi i UKZ-së i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka, Prof. Ass. Dr. Selim Daku- anëtar i Këshillit Drejtues, Prof. Ass. Dr. Arben Sahiti, Betim Berisha dhe znj. Luljetë Berisha nga Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar, kanë qëndruar në Universitetin e Manisas, në kuadër të marrëveshjes së përbashkët ICM për Mobilitet të stafit Akademik dhe Administrativ. Dekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, Prof. Asoc. Dr. Artan Dermaku së bashku me Ass. Dr. Lulzim Rashiti kanë qëndruar në "Univerisdad de Jaen" në Spanjë. Kjo vizitë u realizua në kuadër të programit Ersamus+ ICM, në të cilën vizitë po marrin pjesë mbi njëqind (100) profesorë të universiteteve të ndryshme evropiane dhe të Afrikës Veriore.

Vizita e Rektoren së PH Zug në UKZ

UKZ-ja kanë pritur në takime Rektoren e Universitetit PH Zug nga Zvicra Prof. Dr. Esther Kamm, me bashkëpunëtorët Prof. Dr. Clemens Diesbergen, Prof. Marcus Buesberger dhe Mr. Patrick Pfeuffer. Po ashtu, rrjete të reja për bashkëpunim u prezantuan, të cilat kanë dalur si rezultat i projekteve Erasmus+ CBHE dhe Horizon 2020, në të cilat UKZ-ja do punojë shumë që të bëhet pjesë e tyre. Universiteti Publik "Kadri Zeka" është pjesë e këtij forumi të rendësishëm për universitetet dhe përmes përfaqësuesve të saj do të vazhdojë kontributin në zhvillimin e tij.

Vizita e studentëve të PH Zug në UKZ

Falë bashkëpunimit që kemi me Universitetin e Zug, PH Zug, këtë vit kemi arritur të realizojmë vizitat e studentëve në dy universitet përkatëse. Në tetor 2022, dhjetë (10) studentë zviceran kanë qëndruar në UKZ për një javë. Ata janë akomoduar te studentët tanë. Gjatë gjithë javës, Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar ka organizuar punëtori dhe aktivitete të ndryshme, si dhe vizita nëpër shkollat fillore, çerdhet publike dhe institucionale të ndryshme edukative dhe kulturore. Në kuadër të aktiviteteve në UKZ, janë organizuar punëtori me temë siç janë: sistemetë arsimt; kultura; religjioni; minoritetet; ndikimi i teknologjisë në procesin mësimor etj. Ndërsa, në dhjetor të 2022 katërmëdhjetë (14) studentë të UKZ-së kanë qëndruar për një javë në PH Zug. Ata janë akomoduar në familje zvicerane dhe te studentët që ishin pjesëmarrës në UKZ. Studentët tanë kanë marrë pjesë në aktivitetet që PH Zug ka organizuar; punëtori, panaire, vizita në shkolla, ligjérata.

Vizita e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Kryetari i ASHSH-së, akademik Skender Gjinushi, akademik Gëzim Hoxha, nënkyrytar dhe akademik Shaban Sinani, sekretar, vizituan UKZ-në, me ç'rast u nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi dhe i dhuruan UKZ-së një fond me libra (botime të ASHSH-së) prej 200 titujve, në 400 ekzemplarë.

UKZ u vizitua nga përfaqësues të njëmbëdhjetë (11) Universitetet nga Polonia

Në kuadër të projektit Erasmus+ ENEMLOS, në Universitetin Publik "Kadri Zeka" qëndruan njëmbëdhjetë (11) përfaqësues të Universitetet nga Polonia, duke nisur nga Universiteti i Varshavës e deri tek ai i Krakovës. Vizita është realizuar me qëllim të funksionalizimit të klinikave ligjore në UKZ.

Vizita në PH Zug

Rektori i Universiteti Publik “Kadri Zeka” Prof. Dr. Bajram Kosumi së bashku me Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte, Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka, kanë qëndruar në një vizitë në Zvicër konkretisht në Universitetin PH Zug. Gjatë kësaj vizite ata janë takuar me Rektoren e Universitetit PH Zug, Prof. Dr. Esther Kamm dhe me ekipën e saj, gjithashtu, me disa studentë të PH Zug. Në këtë takim është diskutuar rreth vizitës studimore të studentëve zviceranë në UKZ dhe studentëve të UKZ-së në PH Zug; vizita këto të cilat tashmë realizohen tash e disa vite si pjesë e marrëveshjes dhe bashkëpunimit që UKZ gëzon me PH Zug. Po ashtu, me Rektoren Kamm janë diskutuar edhe çështje tjera rreth bashkëpunimit që UKZ-ja ka me PH Zug, duke përfshirë edhe vizitat

Raporti Vjetor i Punës 2022– Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan e profesorëve zviceranë në UKZ dhe anasjelltas; realizimi i një konference të përbashkët si dhe projekte në kuadër të bashkëpunimit mes dy institucioneve, me theks të veçantë thellimi i bashkëpunimit në kuadër të stafit akademik dhe administrativ, si dhe potencialisht i shkollave fillore.

Vizitat monitoruese

Pjesëmarrja në projekte dhe implementimi i tyre nga ana e partnerëve është pjesa më e rëndësishme. Mirëpo, për të parë nga afër mënyrën e implementimit, organizohen vizita monitoruesë nga Zyra e Erasmus+ në Kosovë.

Gjatë viti 2022 vizitat monitoruese kanë ndërruar format, sepse ato nuk do të realizohen si në vitet e kaluara në prezencë fizike, por gjithsesi në UKZ është mbajtur vizitë monitoruese nga përfaqësueset e zyrës së BE-së në Prishtinë, për projektet në përgjithësi, të cilat bënë pjesë UKZ-ja dhe mbarëvajtjen e tyre. Komenti i zyrës Erasmus+ në Prishtinë: “Turneun nëpër Universitetet Publike të Kosovës e filluam me një vizitë në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan. Ky Universitet ka treguar sukses dhe potential të madh si partner granti dhe koordinator në projektet #Erasmus+. Zyra Kosovare Erasmus+ është këtu për të promovuar dhe mbështetur universitetet dhe u uron atyre suksese të mëdha në të ardhmen”.

Ditët informuese ERASMUS +

Përgjatë tri (3) ditëve ishin prezantuar aktivitetet e zhvilluara në Universitetin “Kadri Zeka” të cilat ishin të llojullojshme. Studentët dhe Stafi Akademik e Administrativë i UKZ-së në ditët informuese (Erasmus Days) për projektet Erasmus+, organizuar nga Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, shfaqën aktivitetet e ndryshme përgjatë vittit 2022, si dhe planet për vitet ne vijim, me ç'rast pati interesim të madh nga të gjithë të involvuarit. Aktivitetet u organizuan rrëth mënyrës së aplikimeve, përbajtjes dhe përmbledhjes së punimit të projekteve të programit Erasmus+.

Ndërkaq, rrëth prezantimit të punës në projekte ndërkombëtare dhe rrëth aktivitetet e tjera gjatë këtij sesioni të pranishmit janë informuar nga Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar në UKZ Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka, i cili ka paraqitur veç e veç projekte ndërkombëtare të UKZ-së: Projektet Erasmus+ (QUADIC, ENEMLOS, QATEK, SIAHDPC, STAND, SMAHPC, E-Viva) etj.

2. PËRFUNDIM

Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, në vitin 2022:

- Ka vazhduar me sukses përbushjen e objektivave të përgjithshme strategjike të përcaktuara nga Plani Strategjik 2017-2022, duke zhvilluar me sukses secilën prej objektivave strategjike në vazhdimësi të viteve të mëparshme.
- Ka realizuar dhe shfrytëzuar buxhetin e përcaktuar në funksion të realizimit të të gjitha aktivitetevemësimore-shkencore të Universitetit.
- Numri i stafit akademik është rritur në cilësi (janë avancuar një numër i konsiderueshëm i stafit akademik) dhe në sasi (janë pranuar numër i ri i stafit akademik dhe administrativ).
- Infrastruktura e UKZ-së është përmirësuar, duke u pajisur me salla të mësimit të rinovuara, me një amfiteatër të vogël, pajisjet teknologjike dhe pajisje të tjera.
- Ka vazhduar me sukses organizimi i studimeve master të akredituara për herë të parë (nga 1 tetor 2021).
- Numri i studentëve të kërkuar me konkurs është përbushur; është organizuar procesi i pranimit të studentëve të rinj, procesi mësimor, diplomimi i tyre; vlen të theksohet se numri i aplikantëve përpranim ka qenë më i madh se numri i lejuar për regjistrim.
- Janë realizuar me sukses hulumtimet shkencore dhe konferencat shkencore. Stafi akademik ka publikuar punime në revista të indeksuara në Scopus dhe WoS, janë mbështetur financiarisht 20 punime shkencore dhe është shpallur Hulumtuesi më i mirë i vitit.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar ka vazhduar me sukses implementimin e projekteve Erasmus+ dhe është punuar në aplikimin e projekteve të reja. Janë arritur marrëveshje bashkëpunimi me universitetet dhe institucione tjera.

Përfundimisht, ky vit i punës së UKZ-së, ka realizuar me sukses misionin e tij për të kultivuar nxëniet dhe zhvillimin e dijeve; nxitje të mendimit kritik dhe shpirt të ndërmarrësisë për hulumtime të reja, të cilat e ndihmojnë zhvillimin shoqëror dhe atë teknologjik, duke përgatitur të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie virtuale e globale, pjesë e një tregut të hapur të punës, njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Gjilan, 27.03.2023

Kryesuesi i Këshillit Drejtues të
UKZ-së